

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7735 E martë 11 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Ata e dinë vetë çfarë bëjnë edhe nuk kanë nevojë për këshilla, as për teori konspiracioni. Të premtën vendosën ç'do bënin për të shtunën me forcën ...
Vijon në faqen 20

Nga EDVIN PARRUCA

Studentët, OP, demokracia



Opinion i Ditës

Nëse doni të kuptoni se sa i dëshpëruar, pa fantazi, i plakur, demode, me një propagandë shterpë dhe pa mundësi zgjidhjeje ishte monologu i sotshëm ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Plaku demode që nuk di të flasë më për veshët e studentëve



Falsifikimi, hetime në Shqipëri dhe SHBA

Tenderi 11 milionë euro anulohet pas emisionit në "News 24", Basha: Rama i dha firmës 30 milionë euro

Skandali, "DH Albania" fitoi kontratën e energjisë, OST: Pas "Të Paekspozuarit" e pezulluar kontratën

Skandali i kompanisë fantazmë "Dunwell Haberman", e cila u shpall fituese në tenderin për Unazën e Re merr përmasa edhe më të rënda. Dje u publikuan dokumentet zyrtare që tregojnë se vetëm një muaj më parë, Operatori i Sistemit të Transmetimit i ka dhënë kompanisë 'offshore' nga Delaware, përmes degës së saj në Tiranë ...
Në faqen 13

PROTESTA/ SOT BLOKOHEN UNIVERSITETET: QEVERIA KA AFAT DERI PASDITE

STUDENTET: TE PLOTESOHEN 4 KUSHTET, OSE GREVE URIE

Të rinjtë: Jo negociata, arsim falas. Reagon Rama: Ose dialogojmë, ose rrini në rrugë. Qeveria, e gatshme të përgjysmojë tarifat. Ky nuk është dhjetori i fundit



(Në foto) Studentë duke protestuar përpara Ministrisë së Arsimit. Kryeministri Edi Rama

PARALAJMERIMI

Infermierët: Do të protestojmë më 20 dhjetor, ka kërçenime por s'do heqim dorë

Në faqen 6

DEPUTETJA DEMOKRATE

Vajza e Hajdarit lajmëron largimin nga PD-ja: Nuk po kuptohemi në popull

Në faqen 7

PROPOZIMI I LLESHAJT

Projektligji, ushtarakët mund të bëhen pjesë e forcave të policisë


Në faqen 8

BURGU I BURRELIT

55 të dënuar, letër Ministrisë së Drejtësisë: Amnistia të na prekë edhe ne

Në faqen 12

PRETENCA



Trafiku i drogës, prokuroria italiane kërkon 18 vite burg për Moisi Habilajn

Në faqen 9

Intervista/ Eksperti Hasan Hoxha: Duhet amnistuar kontributet e paguara në bujqësi

"Skema e kontributit të fermerëve, efekte negative"

Pensionet, ish-zv.drejtori i ISSH: Si shmangen rastet abuzive

Nga VOLTIZA DURO

Problemet në skemën e kontributëve të të vetëpunësuarve në bujqësi janë shoqëruar edhe me efekte negative në fushën e përfitimeve. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", ish-zv.drejtori i përgjith-



shëm i ISSH-së, prof.as.dr. Hasan Hoxha tregon profilet në të cilat paraqitet struktura e përfitimeve brenda skemës. Eksperti thekson se një pjesë e përfitimeve (sado e vogël të jetë ajo) bie ndesh me kriteret ligjore të përcaktuara. Hoxha e vlerëson si të ...

Në faqen 10-11

PROTESTA E STUDENTEVE PERPLASJA

Të rinjtë kërkojnë arsim falas, ultimatumi skadon në orën 4 pasdite

Studentët: Sot përshkallëzohet reagimi ndaj Ministrisë së Arsimit

"Jo negociata, të plotësohen kërkesat tona"

Studentët e universiteteve të Tiranës dhe rrethëve refuzuan dje kërkesën për dialog të kryeministrit Rama dhe vijuan qëndresën e tyre para Ministrisë së Arsimit. Studentët kërkojnë përmbushjen e kushteve të tyre në kundërt kanë paralajmëruar përshkallëzim të reagimit. Në një postim në rrjetet sociale, përfaqësues nga të gjithë fakultetet publike në vend, kanë njoftuar se në orën 07:00 të mëngjesit të ditës së martë, e deri në orën 10:00, do të bllokohen të të gjitha hyrjet e fakulteteve, çka nënkupton bojkot total të universiteteve.

Po ashtu bëhet e ditur se në orën 10:00 do të nisë marshimi nga të gjitha fakultetet, drejt rrugëve të të shpirtit për në Ministrinë e Arsimit, atje ku është protestuar prej një jave. Ashtu sikurse lajmëruan në fund të protestës së sotme, ora 16:00 është afati i fundit që studentët i kanë lënë qeverisë për të plotësuar 8 kërkesat.

Në skadim të këtij afati, janë paralajmëruar përshkallëzim, deri në grevë urie. Ndërkohë, në rrjetet sociale po qarkullon një tjetër njoftim, ky edhe më radikal për nga përmasat e protestës. Në këtë njoftim bëhet thirrje që në orën 9:00 të bllokohen të gjitha pikat kyçe të Tiranës, për të "paralizuar" kështu kryeqytetin.

LEVIZJA PËR UNIVERSITETIN

Bazuar në deklaratën e kryeministrit Rama, ku studentët i fuan të negociocin, aktivistët e Lëvizjes Për Universitetin parashitrojnë kërkesat e mëposhtme si të PANEGOCIUESHME:

1. Shfuqizimin e ligjit të arsimit të lartë, si pikënisjen nga ku do mund të rinisë reformimi i vërtetë i jetës universitare, bazuar në lumen e kërkesave të artikuluara nga masa studentore.

2. Dyfishimin e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë. Njëpërmjet tij do të siguro-



Fotografia postohet edhe nga Berisha, edhe nga Rama

"I duam tarifat sa Erjon Braçe", parulla 'hit' bën xhiron e rrjetit

Ka zgjatur mbi 7 orë protesta e djeshme e studentëve. Ata do të rikthehen sërisht sot, ditë kur do të merret edhe vendimi i vijueshmërisë së protestës nëse qeveria nuk i plotëson kërkesat.

Ata kanë lënë orën 16:00 të së martës, si afatin për fundimtar kur qeveria duhet të plotësojë kushtet që ata kërkojnë, në të kundërt bashkërisht do të vendosin për format e përshkallëzimit të protestës.

Ndërkohë, edhe dje studentët kanë mbajtur në duar pankartat e tyre me shënime të ndryshme ku spikaste njëra: I duam tarifat sa Erjon Braçe. Kjo parullë u shndërrua në "hit" duke qenë se u postua edhe nga ish-kryeministri Berisha, edhe nga kryeministri Rama.

Me thirrjet: "Turp! Do dalim në rrugë me qindra e mijëra, po s'u hoq tarifa

heshin: përmirësimi i kushteve të jetesës në konvikte, pasurimi i bibliotekave, zhvillimi i kërkimit shkencor; zgjerimi i mjediseve univer-



rrëzohet ministria" studentët i janë përgjigjur dhe ftesës së kryeministrit për dialog për të zgjidhur kërkesat përmes transmetimit live në Facebook.

Ndërsa për Ramën "është e qartë dhe duhet ta dëgjojnë të gjithë: unë jam me çdo student që do të ishte për veten e tij aty, jo për Lulin jo për Monikën dhe jo për komshinjtë, por për veten e tij dhe shtëpinë, të ardhmen dhe prindërit e tij. Jam i vetëdijshëm që dikush është

sitate dhe i stafit akademik etj. etj... lista është e gjatë.

3. Arsim publik falas në të gjitha nivelet si themel i studimit sipas meritës.

PARALAJMËRIMI
Gazetari i "News 24" Erjon Skendaj tha dje se studentët sot do të jenë para godinës së Ministrisë së Arsimit, por nëse qeveria nuk nxjerr një VKM për plotësimin e kërkesave të tyre, më pas do ta kalojnë protestën para Kryeministrit.



Protesta e djeshme e studentëve

PROTESTA

Studentja në Shkodër: Rama nuk mund të na quajë ngelësa

Pas studentëve, në protesta janë ngritur edhe qytetarë të Shkodrës dhe Kavajës. Ledia, një maturante, e cila i është bashkuar qytetarëve të Shkodrës, në mbështetje të studentëve, ka kritikuar kryeministrin për cilësimin 'ngelës' të disa prej tyre, teksa ka argumentuar se ata e kanë të pamundur t'i përkushtohen studimeve për faktin që detyrohen të punojnë.

"Unë jam Ledia, një maturante që pret të hyjë në universitet, prindërit e mi janë të paafte për të paguar tarifat. Unë kam mbushur 18 vjeç dhe prapë nuk mund të gjejë punë, prindërit e mi nuk mund të përballojnë koston minimale të jetesës.

Kryeministri nuk mund të na quajë ngelësa, sepse bashkëmohatarët e mi nuk kanë kohën e mjaftueshme për të studiuar, ndërkohë që punojnë 6 orë në call center, apo si kamarierë", u shpreh ajo.



ësh, të zgjedhur me votë të barabartë studentësh dhe pedagogësh në çdo fakultet universitetesh publike.

Kërkesat e artikuluara nga masa e studentëve nuk duhet të bëhen në asnjë mënyrë objekt negociatash, pikë pas pike. Së pari, sepse pikat janë të pafundme. Së dyti, sepse kërkesat duhet të pranohen në bllok nga qeveria! Që të arrihet kjo, NUK KA NEGOCIATA pa anulimin e ligjit në arsimin e lartë dhe rifillimin e një fushate nga universitetet - studentët dhe pedagogët - për hartimin e reformës në arsim. Lista e kërkesave nuk mund të implementohet pa TË PAKTËN dyfishimin e

buxhetit të shtetit për arsimin. Ky dyfishim është i nevojshëm edhe për kërkesën kryesore të artikuluar nga studentët në këto ditë protestash: ARSIM PUBLIK FALAS!

REFORMA E RE në arsim do të rinisë qe vatra e dijes dhe e rezistencës, nga ata që u inorjuan tërësisht nga reforma e mëparshme në arsim, nga ata zëri i të cilëve kumboi fuqishëm gjatë ditëve të protestës: STUDENTËT. Në procesin e reformimit të arsimit do duhet të marrin pjesë edhe pedagogët, fakultet pas fakulteti, nëpër asambletë universitare që do krijohen në universitetet publike.

8 kërkesat, kryeministri premtom lehtësira: Kush përfiton tarifa të përgjysmuara

Protesta e studentëve, Rama: Ose rrini në rrugë, ose dialogojmë

"Hajdeni pushtoni zyrën time"



Kryeministri Edi Rama ka tentuar pa sukses dje që të hapë një kanal komunikimi me studentët, të cilët sot vijojnë për të shtatën ditë me radhë protestën e tyre përpara Ministrisë së Arsimit. Përmes një komunikimi direkt në rrjetin social "Facebook", kreu i qeverisë u ka shtrirë atyre dorën e bashkëpunimit për t'u dhënë zgjidhje të gjitha kërkesave që ata kanë parashtruar gjatë këtyre ditëve. Por, që kërkesat e tyre të marrin zgjidhje, kryeministri ka kërkuar prej tyre që të përcaktojnë një përfaqësi dhe të dialogojnë. "Nëse protesta është e atyre që dolën spontanisht në një protestë për një gjë të drejtë, duhet të dialogojmë. Dialogu nuk është një akt martese me zor, por është një akt ku palët flasin dhe dëgjojnë. Si mund të jemi sot në këtë Shqipëri, duke bërë një rrugë të gjatë dhe të vështirë dhe të punojmë kundër dialogut me qeverinë dhe kryeministrin. Pse, çfarë është kryeministri, dyan, magazinë, ku shkruhen kërkesat dhe merren përgjigjet nga televizori?", - u shpreh kryeministri që në nisje të komunikimit të tij të drejtpërdrejtë.

DIALOGU

Më tej, ai u shpreh se të gjitha kërkesat janë të zgjidhshme, por për këtë ai theksoi se duhet bashkëpunim. "Duhet dialog, sepse 'i kemi të gjithë këto halle dhe shpresoj të zgjidhen'. Nga kush? Nga Zoti? Kush jam unë? Zoti jam unë, që i zgjidh në mënyrë magjike të gjitha nga lart?! I shkruajmë kërkesa Zotit lartë dhe nuk pranojmë as ta takojmë, por i themi 'dërgo zgjidhjet! Zgjidhjet të gjitha janë të mundura, por gjetja e zgjidhjeve bëhet në një rrugë të përbashkët, sidomos për ato gjëra që kanë të bëjnë me brendinë e universitetit, sepse qeveria nuk futet dot në universitet", u shpreh Rama. Kryeministri ndërsa i konsideroi studentët që protestojnë si aleatë të tij në zgjidhjen e situatës në të cilën ndodhet arsimit lartë, ka kërkuar prej tyre që të distancohen nga përdorimi politik. "Ju jeni aleatë tanë, ju jeni aleatë e mi. Ju nuk jeni aleatë e Lulit. Ju nuk jeni aleatë e Monikës. Ju nuk jeni aleatë e komshinjve. Ju nuk jeni aleatë e atyre që krihen para pasqyrave në mbremje, duke urar që të digjet fshati në mëngjes. Ju jeni aleatë e mi, unë jam aleati juaj e unë dua të luftoj bashkë me ju, jo për të bërë këto që kërkoni ju, por për të bërë shumë më tepër se kaq. Prandaj ndahuni nga ata që ju thonë 'mos dialogo', 'mos fol', shtoi kryeministri.

TARIFAT

Duke u ndalur te kërkesa e studentëve për përgjysmimin e tarifave, Rama u shpreh i gatshëm t'i rishikojë ato, duke i hequr fare për studentët e mirë dhe ata që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike. "Tarifat jemi gati t'i rishikojmë pa diskutim, por jo tarifën, por ndihmën e qeverisë dhe të shtetit për ju, në pagesën e tarifave, sepse tarifën janë kosto të nxjerra. E ndërkohe do bëjmë transparencën e tarifave. Do ta marrim tarifën kështu siç është, ne do ju japim nga buxheti 50%". Pse jo më shumë se 50%? Pse ia ulim tarifën 50% studentëve që janë me 9 dhe atyre me 10 ia heqim fare? Ia paguajmë ne të gjithën. Aty-



Kryeministri Edi Rama

PËR TAULANT MUKËN

"Do vish ta bësh ti i thashë, të iki ai, të shkosh ti në vend të atij. Si - tha, po kjo që po më thonë ju është diçka që nuk e prisja. Po ti nuk pret shumë gjëra të tjera - i thashë, - në fakt isha unë që nuk e prisja. Çfarë bëri? Ditën e parë, dua veturë dhe shofer. - Po nuk kanë vetura zëvendësministrat. Nuk i kemi me vetura. - Si ka mundësi? Po banjën pse nuk e kam në zyrë? Po kjo? Po ajo? 'Babain e dua shofer të punësuar në ministri'."

BORDET

Kreu i qeverisë në kuadër edhe të plotësimit të kërkesave të studentëve për alajmëri edhe shkarkimin e të gjithë përfaqësuesve të qeverisë në bordet e administrimit të universiteteve. "Një nga gjërat që duam të bëjmë është që do t'i shkarkojmë të gjithë përfaqësuesit e qeverisë në bordet e administrimit, që të gjithë. Si ju duket kjo? Por nuk bëj asnjë lëvizje unë, po nuk erdhën për të diskutuar. Të dilni t'i vini fytyrën, t'i vini mendjen, t'i vini zemrën kësaj punë. Për të bërë universitetin, jo për të recituar në emër në të Lulit dhe Monikës atje", tha Rama. Por, ai theksoi se ishte e pamundur që studentët të kishin një përfaqësues në bordet e administrimit, por që zëri i tyre të dëgjohet në to, Rama ofroi që përfaqësuesin e qeverisë ta zgjedhin studentët. "Bordet e administrimit jemi gati t'i shkarkojmë të gjithë. Nuk e fusim dot në ligj praninë e studentëve në bordet e administrimit, nuk e ka asnjë vend. Ajo që mund të bëjmë, por as kjo nuk do të bëhet nëse nuk do vini të bisedoni, është që për sa kohë është kjo qeveri, pa asnjë problem, një nga të emëruarit e qeverisë do të jetë

një i zgjedhur nga ju në universitete. Sesi e zgjidhni, me këshill, senat apo çfarë të doni, si të doni ju, vetëm sillni emrin e vendosni vejtë mekanizmin. Nuk e zgjedh qeveria që të marrë një student kukull e ta vendosë atje dhe ne do e çojmë në bordin e administrimit direkt dhe s'kemi dhimbje koke fare", u shpreh kryeministri. Ai u shpreh i gatshëm që të bashkëpunojë me studentët edhe për t'u vënë fre abuzimit të profesorëve me notat dhe shitjen e librave. "Po të kishit ardhur këtu dhe të vini këtu më parë, që t'u vinim kufirin të thana këtyre profesorëve që ju marrin lekë për provimet, që ju thonë blini librin tim se unë iu notën dhe ju u notën, etj.. bëhet ndryshe biseda. Keni nevojë për qeverinë, keni nevojë për kryeministrin? Apo do i zgjidhni vetë të gjitha? Zgjidhni, shumë mirë, malet tuaja më të larta. Nuk ishit ju, sepse tani kemi filluar të belbëzoni, të thonë janë edhe profesorët, se është edhe ky edhe ai. I thonë me zë të ulët, do dalin pak nga pak dhe po ndenjëjtë edhe shumë aty, ikët, ju mori kuqçetra, ju futi në cizme, më dëgjoni mua".

EKSELLENDET

Nga ana tjetër, kryeministri ofroi edhe një favor më shumë për studentët, që s'ka të bëjë me kërkesat e tyre. Ai theksoi se ishte gati që 1 mijë studentët më të mirë të universiteteve shqiptare të kishin punësimin e garantuar në administratën shtetërore. "I mijë vende pune në administratë nga klasifikimi i studentëve me mesatare 9deri në 10, në të gjitha fushat, të cilëve u ofrohet vend pune. Psh., jam unë i pari, kam mbaruar financë, ka vendin e punës gati Ministria e Financave, pa konkurs fare, me notat e mia, mund të punoj një vit që të fitoj eksperiencën dhe pastaj të hyj në konkurs në Departamentin e Administratës Publike, ose 3 vjet, nuk ka rëndësi", shtoi Rama.

KONVIKTET

Duke prekur një nga kërkesat kryesore të studentëve dhe që ka të bëjë me kushtet në konvikte, Rama tha se tashmë ka nisur të konkretizohet projekti i bashkëpunimit me qeverinë gjermane. "Pa tjetër që mjediset duhen përmirësuar. Një nga vetë nuk kam çfarë them, nuk kam çfarë flas para pambjeve të konvikteve. Por, nga ana tjetër edhe këtu ka shumë nga ata që përtojnë të shikojnë në këtë hapësirë tonë dhe thonë 'ah 3 D'. Dakord, por nga ana tjetër, ju vetëm 3 D, por edhe konkretisht ne kemi një investim 18 milionë euro", shtoi kryeministri. Ai tregoi se për rikonstruksionin e konvikteve të studentëve i kishte kërkuar ndihmë edhe kancelares gjermane dhe investimi prej 18 milionë euro është produkt i asaj bisede. "Konviktet e studentëve ia kam kërkuar kancelares gjermane Angela Merkel, këtu në Tiranë, kur ka ardhur për vizitë. E mbani mend? Atë vit në korrik i kam kërkuar këtë gjë, pastaj vijoi procesi, hyri në ato rrugë e burokracisë dhe si përfundim janë 18 milionë euro që ka filluar investimi. Është investim real, tek Fakulteti i Ndërtimit, tek Qyteti i Studentëve nr.2. Është projekt në fazën e parë, shkon deri në 56 milionë euro në total, sepse disbursohet me faza, duhen vite", shtoi Rama. Ai gjithashtu u ofroi studentëve edhe një bonus tjetër që ka të bëjë me rimbursimin e një pjese të tarifës së konvikteve për sa kohë këto të fundit nuk janë rikonstruksionuar ende.

KAMPUSI

Kryeministri foli edhe për idenë e kampusit universitar, ndërsa bëri të ditur se tashmë Bashkia e Tiranës ka filluar me punën për krijimin e sheshit ku do të shtrihet ai. "Ndërkohë me Bashkinë e Tiranës e kemi vënë në vijë. Bashkia e Tiranës ka kohë që ka filluar punën për të liruuar sheshin. Tek sheshi, tek sheshi thoni ju, por sheshi janë 'tokë e xanun'. Tek sheshi i Qytetit Studenti është 'tokë e xanun'. Do të jetë një projekt që do të angazhohemi publikisht e do ta financojmë dhe në katër vitet e ardhshme të mandatit tjetër të bashkisë do të jetë kampusi universitar", u shpreh kryeministri.

VETINGU

Kreu i qeverisë ka folur edhe për kërkesën e studentëve për vetingun e pedagogëve, duke theksuar se ai nuk mund të realizohet nëse ata nuk bashkëpunojnë. "Kush ta bëjë apo ta bëjë unë. Jo, jo, unë nuk bëj asgjë për ju, ose hajdeni bëjmë bashkë, ose rrini atje. Këtë di të them unë. Unë për ju bëj gjithçka nëse ju jeni gati të luftoni për veten tuaj. Nëse ju jeni gati të jeni të zotë e vetes e të fatit tuaj, ta tregoni me dinjitet e me seriozitet kur një pedagog guxon t'ju afrohet, për t'ju insinuar se mund t'i jepni lekë apo se mund t'i blini librin. Dhe hajdeni tek unë. Çfarë do bëjmë ne bashkë? Jeni më të fortë po të vini tek unë, ta luftojmë bashkë atë pedagogun dhe nuk ju hyjnë gjemb në këmbë. Rrini atje, për çfarë ta bëjë unë vetingun e pedagogëve? Ose shkoni bëjeni me Lulën, se Luli i bën vetingjet. Ai është profesionist i vetingut. Vetingun e politikaneve e mbaroi, e çoi dhe në Venecia dhe prite tani kur të drejtë Venecia na dha ne të drejtë. Shkoni bëjeni me Lulin vetingun, apo me Monikën, se Monika është doktore shkencash. Është kokë e madhe", tha Rama.



Kreu i qeverisë: Ky nuk është dhjetori i fundit

Në të gjithë vendin janë intensifikuar protestat e shumë grupeve të interesit që nga studentët shoferët e bizneset, por kryeministri Edi Rama është bindur se opozita nuk do arrijë kurrë që shëndërrtojë këtë muaj në dhjetorin e fundit të qeverisë së tij. Duke folur dje nëpërmjet "Facebook"-ut, kryeministri i ka kthyer një përgjigje edhe opozitës, duke besuar se ajo është pas gjithë kësaj vale protestash. "Po tarifën e konvikteve në ato kushte mizerje, nuk është e udhës që edhe qeveria të marrë përgjegjësi aty, meqë nuk ia ofron kushte më të mira, të paktën nuk mundet qeveria të marrë përgjegjësi aty, sado të vogël për tarifë dhe të thotë në çdo konvikt ku ne nuk kemi arritur akoma të rindërtojmë, se nuk mund t'i rindërtojmë të gjitha përnjehër, se Shqipëria u shkatërrua për 25 vjet. Se do të thoni ju, po mirë sa do të rrih ti. Se sa do të rri unë është një temë tjetër dhe e flasim një ditë tjetër, po ky nuk është dhjetori i fundit", tha Rama.

PROTESTAT NË RRETHE PARALAJMËRIMI

Qytetarët bllokojnë rrugët në Shkodër, Lezhë, Himarë, Kavajë e Vaun e Dejës

Valentina Madani

Protestat shtrihen në gjithë Shqipërinë, duke kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama. Pas studentëve në Tiranë, në protesta dje dolën edhe banorët në Kavajë, Shkodër, Vaun e Dejës dhe në Lezhë. Por, protesta po dje pati edhe në Himarë, ndërkohë që sot pritet që ato të përhapen edhe në rrethe të tjera të vendit. Qytetarët në zona të ndryshme të vendit u solidarizuan me protestën e studentëve në Tiranë, ndërkohë që parashtruan edhe kërkesa që kanë të bëjnë me çmimin e lartë të naftës. Qytetarët bënë thirrje për largimin e kryeministrit, ndërkohë që z.Rama i komentoi protestat e mbajtura në Shkodër, Lezhë dhe Kavajë. Sipas Ramës, këta që protestojnë janë punonjës të bashkive. "Interesant. Punonjësit e Bashkisë Lezhë protestojnë si fermerë, të Bashkisë Shkodër si shoferë dhe të Bashkisë Kavajë si francezë. Studentët s'duhet të dialogojnë, por duhen mbajtur peng me çdo kusht që të përdoren si qendër gravitimi e revolucionit të Lulit & Monikës. Jo politikë!", shprehet z.Rama.

LEZHA

Në superstradën Lezhë-Shkodër fermerët bllokuan rrugën me thirrje kundër qeverisë, që sipas tyre i ka varfëruar. Kushitet e vështira ekonomike, çmimi i karburantit, por edhe probleme të tjera janë disa nga arsye të protestës. Fermerët në Lezhë janë të vendosur të vazhdojnë protestat e tyre deri në largimin e kryeministrit Rama. Banorët e Lezhës veshën jelekë të verdhë për të protestuar duke marrë shembull nga demonstratat në Paris. Pas reagimit të kryeministrit Rama për protestuesit në Kavajë, Shkodër e Lezhë, ku tha se kanë qenë punonjësit e bashkive, të cilët kanë dalë të protestojnë, ka reaguar Bashkia e Lezhës. Në një njoftim zyrtar thuhet se, "Bashkia Lezhë sqaron opinion publik se asnjë punonjës i këtij institucioni nuk është në protestën që po mbahet në Shkodër, të paktën në mënyrë të organizuar. Sa u përket banorëve të Lezhës, kjo është një përgjigje që mund ta japin si grupe interesi", thuhet në njoftimin e Bashkisë së Lezhës.

SHKODËRA

Protesta në Shkodër u zhvillua në dy pika, e para në fshatin Kosmac, ku banorët të veshur me jelekë të verdhë si protestuesit në Francë bllokuan rrugën Shkodër-Lezhë për rreth 60 minuta, ndërsa pika e tjetër ishte në hyrje të qytetit, në "Xhabije".

Fermerët e biznesi, shpërthejnë protestat në rrethe, kërkesat

Rama: Punonjësit dolën në protestë si fermerë



Protesta dje në Shkodër

"Shteti po na detyron të bëjmë vetëgjyqësi"

Protesta, banorët bllokojnë punimet e projektit të Spilesë

Edhe banorët e Himarës ishin dje në protestë. Ata bllokuan punimet për rikualifikimin urban të Spilesë në Himarë. Ata thanë se projekti është abuziv dhe është bllokuar me vendim gjykatë dhe se do t'i mbrojnë pronat me gjak. "Po na hyjnë në pronë, nuk na njohin aktet e pronësisë. Shteti po na detyron të bëjmë vetëgjyqësi", - shprehen banorët. Në dhjetor të vitit të kaluar, Gjykata e Vlorës shfuqizoi vendimin e Këshillit Bashkiak për rikualifikimin urban të Spilesë. Në dhjetor të vitit të kaluar, Gjykata e Vlorës shfuqizoi vendimin e Këshillit Bashkiak për rikualifikimin urban të Spilesë.



Me flamurin kuq e zi në dorë, ata bllokuan rrugët ndërkohë që kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. Njëri nga protestuesit në Shkodër ka hedhur sende të forta në drejtim të Prefekturës duke thyer një xham, ndërsa kanë vijuar me thirrjet kundër qeverisë "Rama". Pas mbi një orë protestë në lagjen "Xhabije" dhe në rrugët e qytetit janë shpërndarë duke paralajmëruar sërish protestë. Policia shkoi pranë tyre duke u kërkuar që të largoheshin nga rruga sepse sipas

tyre, kjo protestë ishte e paligjshme. Arian Peraj, kryetar i Sindikatës së Arsimitit në Shkodër u bëri thirrje nxënësve dhe mësuesve të bojkotojnë mësimin dhe të ngrihen në protestë. Protestuesit nuk kanë dhënë një afat se sa do pritet të vazhdojë kjo protestë. "Poshtë qeveria, poshtë kriminelët", dëgjohej brohorimat e qytetarëve në Shkodër. "Populli është shumë i pakënaqur me Edi Ramën. S'duhet të ndalim protestat që janë ngurit në mbarë vendin. Të sh-

SOLIDARIZIMI

Qytetarët në zona të ndryshme të vendit u solidarizuan me protestën e studentëve në Tiranë, ndërkohë që parashtruan edhe kërkesa që kanë të bëjnë me çmimin e lartë të naftës. Qytetarët bënë thirrje për largimin e kryeministrit, ndërkohë që z.Rama i komentoi protestat e mbajtura në Shkodër, Lezhë dhe Kavajë.



Shembja e ndërtesave tek Unaza e Re

Meta në Marok: Po punojmë për të kapërcyer sfidat e emigracionit

Kreu i shtetit, Ilir Meta, ndodhet në Marok, në kuadër të konferencës ndërkombëtare të nivelit të lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në Marakesh, për të adaptuar "Kompaktin Global për migrim të sigurt, të organizuar dhe të rregullt". Fokus i këtij takimi ndërqeveritar kanë qenë sfidat e emigracionit. Presidenti i Republikës, Meta, ka folur rreth trendit gjithnjë e më një rritje të nivelit të migrimit, duke thënë se nevojitet një bashkëpunim i përbashkët në këtë drejtim, që do të jetë një ndihmë e madhe për të kapërcyer sfidat e emigracionit. Duke iu drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, António Guterres si dhe 150 krerëve të shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse, Presidenti Meta u shpreh se Kompakti Global është rezultat i trendit gjithnjë në rritje të migrimit dhe një reagim kolektiv e të përbashkët në partneritet dhe solidaritet brenda një kuadri shumë-



Kreu i shtetit, Ilir Meta

palësh. "Të gjitha vendet tona, goftë ato të originës, të transitit apo të vendmbërritjes, preken nga migrimi. Dhe me përvojën që kemi pasur, kemi mësuar se mund ta trajtojmë këtë dukuri vetëm në partneritet, sepse është një proces shumë i vështirë dhe kompleks. Bëhet fjalë për të drejtat e njeriut. Ka të bëjë me menaxhimin e kufijve, ka të bëjë me kostot financiare, ka të bëjë me kohezionin social, me sovranitetin dhe kështu mund të vazhdojë pafund. Ne nuk du-

het të lejojmë që të dobësohemi nga lëvizshmëria njerëzore. Përkundrazi, duhet të fuqizohemi duke krijuar një mekanizëm më human, më dinjitos dhe të sigurt për të qeverisur migracionin 'Kompakti Global'. Reflekton në masë të madhe këtë mendim, duke përfshirë objektivat dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe traktatet përkatëse mbi refugjatët dhe emigrantët", deklaroi z.Meta.

kojmë deri në kryeqytet, atje ta përmbysim këtë qeveri", shprehet një shkodran. "Nëse nuk na plotëson kërkesat qeveria, do të vijojmë me protestat deri në greve urie", thanë banorët e tjerë. Protestuesit në fshatin Kosmac të Shkodrës pas bllokimit të rrugës pasditen e djeshme për 60 minuta, paralajmëruan se do të rikthehen sërish sot në të njëjtin orë.

KAVAJA

Pas Lezhës dhe Shkodrës, biznesi i vogël bllokoi rrugën në Kavajë në shenjë

proteste ndaj taksave të larta dhe çmimeve të larta. Po ashtu, banorët e Kavajës janë solidarizuar me protestën e studentëve në Tiranë, por kanë edhe një kërkesë tjetër me karakter ekonomik, uljen e çmimit të karburantit. Ata bllokuan për disa minuta autostradën, ndërsa paralajmëruan se protesta do të vijojë edhe sot. Kërkesat e përfaqësuesve të biznesit të vogël dhe të Mesëm, që ndodhen aktualisht në Kavajë, janë 4: Të ndalet projekti

korruptiv i zëvendësimit të kasave fiskale. Të ulët çmimi i energjisë elektrike me 30%. Të ulët çmimi i karburantit me 300 lekë për litër. Të rritet pragu i TVSH-së për biznesin e vogël dhe të mesëm nga 20 mln lekë në vit që është sot, në 120 milionë lekë. Përfaqësuesit e protestuesve të biznesit të vogël dhe të mesëm deklaruan se 4 pikat janë të panegociueshme. Mosrealizimi i tyre do të sjellë reagimin e të gjitha biznesëve deri në bllokim aktiviteti.



Kreu i PD: Kryeministri mendon t'i përdorë studentët siç përdori Shullazin

Unaza e Re, Basha akuza Ramës: Ke marrë 4 milionë euro kapar

"Protestat, pasojë e degjenerimit të qeverisë"

Valentina Madani

Kreu i PD, Lulzim Basha nga Unaza e Re ku ishte sërish mbremë në krah të banorëve të "Astirit" akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka marrë një kapar 4 mln euro për këtë projekt korruptiv. Lideri demokrat u vuri emra fajtorëve të asaj që ai e quan vjedhje rekord. Ministri Damian Gjiknuri dhe kreu i ARRSH, Afrim Qëndro sipas tij janë përgjegjësit kryesorë, ndaj duhet të shkojnë në burg. "Kjo që po ndodh është pasojë e degjenerimit të qeverisë. Shqiptarët nuk po e mbajnë më dot peshën e keq-qeverisjes. Prej vitesh vendi nuk qeveriset më. Me një segment ekzistues të Unazës së Madhe, pa asnjë transparencë, lind një projekt i "dhuruar", i cili çon në një tender korruptiv për të mundësuar këtë vjedhje rekord, 40 mln euro për 2 km. Po të mos ishte rezistenca e banorëve, sot këto shtëpi do të ishin prishur. Edi Rama ka marrë drejtpërdrejt përfitimet e kësaj afere. Përfillet një kapar prej 4 mln eurosh si fillim, i cili i është dorëzuar përmes Afrim Qendros, Edi Ramës. Gjithsesi, kjo është një gjë që duhet ta hetojë deri në fund drejtësia", - tha z.Basha.

STUDENTËT

Lulzim Basha akuzoi kryeministrin Edi Rama se po kërkon t'i përcajë studentët duke menduar t'i përdorë ata për të kontrolluar universitetet, njësoj siç përdori Emiljano Shullazin. Basha nuk tha nëse do të marrë pjesë në protestën madhështorë që studentët kanë planifikuar nesër, por u shpreh plotësisht në mbështetje të tyre. "E vetmja që i ka mbetur është se shpresa që duke i përçarë do të vazhdojë të mbajë karrigen dhe tepsinë. Mendon se do t'i përdorë studentët për të kontrolluar universitetet njësoj siç përdori Emiljano Shullazin, e kuptoni në çfarë niveli ka zbritur?! Siç donte me Emiljano Shullazin të diktonte zgjedhjet në universitet, ashtu tani mendon se mund të kthejë protestën e studentëve në një instrument për të kapur plotësisht universitetet. Por studentët, qytetarët e kanë kuptuar se ky sistem është i kalbur", deklaroi kreu i PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

"Edi Rama ka marrë drejtpërdrejt përfitimet e kësaj afere. Përfillet një kapar prej 4 mln eurosh si fillim, i cili i është dorëzuar përmes Afrim Qendros, Edi Ramës. Gjithsesi, kjo është një gjë që duhet ta hetojë deri në fund drejtësia", deklaroi kreu i PD-së.

Protesta te Bulevardi i Ri, Prençi: Qeveria po shkel këtu dy kolonat e Kushtetutës

Banorët e Bregut të Lumit protestuan sërish dje për të kërkuar dëmshpërblimin e plotë për shtëpitë e tyre, të cilat preken nga projekti i Bulevardit të Ri. Protestuesit deklaruan disa herë se nuk do të lodhen së protestuari dhe nuk do t'i lëshojnë shtëpitë e tyre, megjithëse qeveria ka nisur të ushtrojë shantazh ndaj tyre. Ish-drejtori i përgjithshëm i Policisë, Ahmet Prençi denoncoi shkeljen e Kushtetutës në rastin e 40 familjeve të Bregut të Lumit: "Duhet të jemi të qartë se Kushtetuta e Shqipërisë ka dy kolona të rëndësishme në mbrojtje të qytetarëve: jetën dhe pronën", tha Prençi. Sipas tij: "Të dyja këto gjëra janë cenuar sot nga qeveria që administrohet si krimi kundër jetës së qytetarëve, ashtu edhe krimi kundër pronës së



KLEVIS BALLIU

Deputeti Klevis Balliu, që ishte pranë protestuesve të Bregut të Lumit, i bëri thirrje qeverisë "të hapë veshët, të hapë sytë, se sot ka përballë qytetarë që janë përballur me përparë me një pushtet edhe më agresiv, me një pushtet më diktator, siç ishte ai i Enver Hoxhës dhe në fund ia dolën të fitonin".

qytetarëve. Jemi këtu për të mbështetur këto 40 familje, të cilat nuk kërkojnë asgjë tjetër vetëm që të trajtohen njësoj si 200 familjet e tjera në dy lotet e tjera të Bulevardit të Ri, që janë shpronësuar me çmimin e

tregut. Nuk jemi kundër projektit i cili e zhvillon qytetin, por bëjmë thirrje që bashkia dhe qeveria të vijnë t'i dëgjojnë këta njerëz dhe të bien dakord për t'i kompensuar sipas çmimit të tregut".



Unaza, Vasili: Fundi fatal me burg për kryeministrin, i pashmangshëm

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, e konsideron si fundit fatal të kryeministrin Rama pas vjedhjes tek Unaza e Re, duke theksuar se ky fund është i pashmangshëm. "Vjedhja dhe skandali gjigant i 40 milionë eurove tek Unaza e Re ia ka mbyllur totalisht gojën Ramës. Fundi fatal me burg është i pashmangshëm. Asnjë rrethanë lehtësuese nuk ka. Hajdutët dhe mekanizmi i vjedhjes është shumë i qartë. Kompani mashtruese deri në Amerikë, tendera mashtrues, kryeministër, ministër e drejtorë mashtrues, kjo është gropa septike e korrupsionit, që do të përpljë pakthim Ramën", shprehet z.Vasili. Sipas tij, çdo shpresë e kryeministrin se mund ta mbyllë këtë çështje ka vdekur. "Prokuroria ta vonojë sa të dojë këtë çështje, por nuk e mbyll dot, përveç se do rendojë edhe ajo veten. Publiku i ka në dorë të gjitha faktet të qarta, të pakundërshtueshme dhe asgjësuese. Fundi fatal i Ramës është i pashmangshëm dhe askush nuk e ndihmon dot, as edhe trastat me euro. Kush ka mend, është mirë t'i rrijë larg kryeministrin që vjen erë që të mos qelbet edhe vetë", shprehet kreu i deputetëve të LSI-së.

Humbi gishtin në protestë, efektivja në gjendje të mirë shëndetësore

Efektivja e policisë, Ina Nuka, që u dëmtua me kapsollë gjatë protestës së banorëve të "Astirit" para parlamentit është në gjendje të mirë shëndetësore. 24-vjeçarja u është nënshtruar dy operacioneve në spitalin "Numune Training and Research Hospital" në Ankara. Policia ka humbur vetëm gishtin e madh nga shpërthimi i kapsollës. Mësohet se asaj do t'i merret kockë nga parakrahu dhe tula nga pjesa e legënit për zëvendësimin e gishtit të madh. Por gishi do të jetë vetëm estetik, sepse nuk mund të kryejë funksionin e plotë të tij. Aktualisht Muka është në fazën e mbylljes së plagës së kapsollës dhe më pas do i nënshtrohet operacionit estetik. Autori i dyshuar që hodhi kapsollë ndaj policës, 18-vjeçari Daniel Dobra, ndodhet në burg. Efektivja e forcave "Shqiponja" u plagos në protestën e 22 nëntorit, që zhvilloi para Kuvendit banorët që preken nga projekti i Unazës së Madhe.

laroi kreu i PD-së.

BANORËT

Me pankarta në duar dhe parulla, banorët e Unazës së Re, në kor kërkuar plotësimin e kërkesave të tyre, atë të dëmshpërblimit 100% të objekteve që preken nga ndërtimi i projektit të "Unazës së Madhe". "Falemind-

erit për rezistencën qytetare të këtij vendi, se me qytetari fitohet çdo gjë. Banorët e Unazës së Re kanë dëgjuar në media se studentët kanë kërkuar bashkimin e tyre në protestë. Ne bëhemi me studentët. Studentët janë bijtë tanë. E gjithë Shqipëria është ndezur për të mbrojtur të

drejtat e tyre legjitime. E kemi kthyer Unazën e Re në një forum qytetar, të shtetit që ka dalë nga shinat. Mesazhi tjetër është për të gjithë banorët. Se studentët kanë nxjerrë një shprehje, lini kafenenë dhe na bashkohuni. Jemi me studentët", tha avokati Artan Manushaqe.

PROTESTAT PARALAJMERIMI

Kreu i Shoqatës së Infermierëve: Na kanë kërcënuar, por ne nuk heqim dorë

Bluzat e bardha paralajmërojnë protestën në 20 dhjetor, shkaqet

Jaçaj: Kartolina, i vetmi shpërblim që morëm në fundvit

Voltiza Duro

Në 20 dhjetor të këtij viti, bluzat e bardha do të protestojnë për të drejtat e tyre e kushte më të mira në vendin e punës. Ata do të mbledhen para QSUT-së dhe do të marshojnë para Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të denoncuar çdo fenomen që përdhos bluzën e bardhë, për t'u rikthyer vlerat dhe humanizmin profesionale të shëndetësisë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Elson Jaçaj, kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, njëkohësisht infermier në QSUT tregon të gjitha shkaqet që i shtynë bluzat e bardha në protestë. Ai thekson se do të kërkojnë rritje page, shpërblim çdo fundvit dhe kushte më të mira pune. Jaçaj thekson më tej se do të kërkojnë verifikimin e diplomave dhe licencave të punonjësve të shëndetësisë, pasi janë evidentuar raste pa licencë e madje edhe pa diplomën përkatëse. 20 prej tyre vetëm në QSUT. Kreu i shoqatës shton se Urdhri i Infermierëve, jo vetëm nuk pranon të bashkëpunojë, por penalizon infermierët.

Pse do të protestojnë bluzat e bardha në 20 dhjetor të këtij viti?

U nis si një nevojë për infermierët, pasi janë kontakti i parë me pacientin dhe kalojnë kohën më të madhe me ta. Është jo vetëm zhgënjyese, por edhe ofenduese që në fundvit të jepet një copë kartolinë shpërblim. E nisëm për një shpërblim të fundviti, pasi çdokush e meriton.

Cilat janë disa nga kushtet e paplotësuar deri më tani që iu shtynë në protestë?

Vendosëm të kemi pikat dhe kushtet tona, ku theksohet jo vetëm rritje page (premtim vetëm në prag zgjedhjes), por të ketë rritje page çdo vit, shpërblim për të gjithë çdo vit, siguri në punë e kushte optimale pune. Do të kërkojmë verifikimin e çdo dosjeje të punonjësve pasi ka plot të punësuar pa licencë, por edhe pa diplomën për-



katëse për të cilën ushtrojnë profesionin. Do të kërkojmë statusin e punonjësit civil, ku të mos hiqemi më nga puna sa herë u do qejfi apo sa herë ndërrohen pushtetet, si dhe të mos ketë më lëvizje të brendshme të infermierëve që kanë mbi 5 vite pune në një pavion, pasi kjo nuk lejon rritjen profesionale të tyre dhe ul performancën e punës. Kërkojmë rishikimin e posteve të kryeinfermierëve që kanë gjithë jetën aty dhe të ketë konkurrencë të drejtë për ta edhe me një mandat 4-5 vjet. Gjithashtu, duhet të paguhen sipas kualifikimit që kanë pasi është premtuar rritje page për ata që janë me master dhe të vlerësohen ndryshe nga të tjerët. Pra, çdokush që kërkon një post drejtues si kryeinfermier apo çdo lloj pozicioni tjetër dhe me drejtimin e UISH duhet të jetë me i kualifikuar; pavarësisht ngjyrimin politik. Kjo, pasi po u kërkon aq shumë kualifikime infermierëve sot e kur vjen puna i ke të papunë, sërish pasi vendet mbahen vakant për kohën e zgjedhjeve.

Duhet që rritja profesionale e punonjësve të ofrohet nga vetë institucionet ku ata punojnë dhe të jetë falas, pasi ata po e kërkojnë për të mirë të tyre.

Ju kemi njoftuar prej disa

KUSHTET

Vendosëm të kemi pikat dhe kushtet tona, ku theksohet jo vetëm rritje page (premtim vetëm në prag zgjedhjes), por të ketë rritje page çdo vit, shpërblim për të gjithë çdo vit, siguri në punë e kushte optimale pune. Do të kërkojmë verifikimin e çdo dosjeje të punonjësve pasi ka plot të punësuar pa licencë, por edhe pa diplomën përkatëse për të cilën ushtrojnë profesionin.

bëjnë, por edhe të diskriminuar me mënyrën se si trajtohen në punë. S'kanë asnjë të drejtë ankese në asnjë zyrë, në asnjë institucion e përgjigja që u jepet kur kërkojnë një të drejtë është: "Mos u ankoni shumë se është bërë radha e gjatë e atyre që kërkojnë punë", pra ushtrohet një formë presioni që nëse ankohen apo ngrënë zërin, rrezikojnë vendin e punës. Kjo i ka shtyrë infermierët të ndihen indiferentë ndaj shumë problemeve që kanë dhe mënyra që zgjedhin është heshtja. Prandaj zgjedhin të ikën, pasi jo vetëm

TRANSPARENCA

Do të kërkojmë transparencë mbi zgjedhjet që po manipulon Urdhri dhe ku shkojnë gjithë këto fonde që merren nga infermierët, pasi asnjë nuk është çuar për trajnim jashtë nga UISH, edhe pse ka detyrim të çojë infermierët për trajnim jashtë.

është i gjithë personeli e jo një pjesë. Jemi vendi që s'dimë ta vlerësojmë këtë profesion, këtë figurë. Pa infermieri, s'ka mjekësi; pa mjekësi, s'ka shëndet e pa shëndet, s'ka jetë.

A ndihen infermierët të nënvlërësuar në vendin e punës?

Infermierët në fakt në faqen tonë zyrtare të shoqatës dhe në takimet me ne shprehin që ndihen jo vetëm të nënvlërësuar për punën që

marrin një pagë më të lartë, por edhe vlerësohen shumë më shumë se këtu si profesionistë dhe si njerëz.

Sa të kënaqur janë infermierët me pagat që marrin?

Deri sot s'kemi parë ndonjë infermier që me rrogën e tij të arrijë të blejë një makinë të mirë, një shtëpi apo diçka tjetër, ndërsa presidentët e Urdhrit të Infermierit pothuajse të gjithë kanë



PD gajtë ceremonisë së 27-vjetorit të themelimit

aksë të jenë pedagogë në universitetet e fakulteteve. Këta persona shpesh i kemi parë edhe me klinika private apo bashkëpunojnë dhe me kompani të huaja për punësimin e infermierëve e kjo i bën të heshtin para çdo problematike që kanë infermierët pasi janë të përlirë në shumë gjëra që s'duhet të ishin. E për të mos folur për Ministrinë e Shëndetësisë, e cila në çdo reformë kur është penalizuese prek infermierët e kur është stimuluese i neglizhon ata, duke mos i stimuluar as me trajnime e as me shpërblime.

Pra, sipas jush, Urdhri i Infermierëve të Shqipërisë ka heshur ndaj problematikave të infermierëve gjatë gjithë kësaj kohe?

Është për të ardhur keq që institucioni i UISH, që duhet të jetë bashkëpunues me shoqatën, pasi sipas nesh duhet të kemi të njëjtin qëllim: atë të punës dhe figurës së infermierëve bashkë me të mirat e të këqijat që ka. Fatkeqësisht UISH ka qenë në heshtje dhe indiferent ndaj penalizimit që iu bë infermierëve të sistemit të Gjenezës, ku edhe pse ne u kemi bërë shkresa, 'email' e u kemi kërkuar takime, s'kemi marrë asnjë reagim.

Si është zgjidhur problemi i personave që ishin diplomuar për infermiere/mami, por licencën e marrin vetëm për mami?

Dua të flas për rastin e mbi 300 mamive që u penalizuan për licencimin dhe punësimin në portal, sepse në diplomë cilësoheshin infermiere/mami dhe në licencë vetëm mami. Kjo i kualifikonte automatikisht jo vetëm këtu, por dhe për t'u punësuar jashtë. Na u dësh të bënim takim me këta studentë, t'i bënim shkresë e ta bënim mediatike derisa Ur-

dri u detyrua të ndryshojë emërtimin nga vetëm mami në infermiere/mami.

Ju pak më lart deklaruat se një prej kërkesave do të jetë verifikimi i diplomave të të punësuarve. Keni konstatuar raste punonjësish pa arsimin përkatës?

Në takimin e fundit (apo debatin e fundit që kishim me UISH) në lidhje me infermierët, pranoi që ka infermiere që ushtrojnë profesionin jo vetëm pa licencë, por edhe pa diploma të profesionit jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe, ku rreth 22 të tillë janë vetëm në QSUT. Në fakt, ne nuk mund të lejojmë më të abuzohet me infermierët dhe së bashku me mbështetësin tonë kryesor për problematikat e infermierëve CRL-AL (Qendra për të drejtat në punë) do të nisim një verifikim për këto raste abuzive. Gjithashtu, do të kërkojmë transparencë mbi zgjedhjet që po manipulon Urdhri dhe ku shkojnë gjithë këto fonde që merren nga infermierët, pasi asnjë nuk është çuar për trajnim jashtë nga UISH dhe pse ka detyrim të çojë infermierët për trajnim jashtë. Gjithashtu, një tjetër problem është mospagesa e praktikave profesionale të infermierëve, pra kur ne marrim studentët në praktika UISH ka detyrim të paguajë infermierin që mëson studentin. Edhe trajnimet apo konferencat që UISH bën me ligj duhet t'ua u ofrojë falas infermierëve, pasi ai është institucioni që kërkon rritjen profesionale të tyre dhe për sa kohë infermierët paguajnë detyrimet ndaj UISH dhe ky i fundit ka detyrim t'ua ofrojë shërbim infermierëve. S'e kërkojmë qëllimim e këtij institucioni që jo vetëm nuk pranon të bashkëpunojë, por përkundrazi penalizon infermierët.



28 vjet, demokratët mblidhen në seli, ftesa edhe për PS-në dhe kritikët e Bashës

'Hap dyert për njerëzit', PD feston sot 28-vjetorin e themelimit

Bashkëbisedim me shkrimtarë dhe intelektualë

Valentina Madani

1 dhjetori kujton hapjen e pluralizmit me lindjen e partisë së parë opozitare në vend në dimrin '90 kur studentët nisën rrugën pa kthim drejt demokracisë. Si çdo 11 dhjetor, edhe sot demokratët do të kujtojnë gjenezën për të nderuar protagonistët e atyre ditëve që bënë histori. Në 28-vjetorin e themelimit do të organizohet një ceremoni festive. Ndryshe nga herë të tjera demokratët do të mblidhen pasditën e sotme në selinë e partisë përgjatë dy orëve nga ora 18:00-20:00. Pritet të ketë shumë të ftuar mes të cilëve edhe trupi diplomatik i akredituar në vendin tonë si dhe krerët e komuniteteve fetare.

AXHENDA

Kreu i PD-së Lulzim Basha nuk është kursyer në ftesat e tij për të marrë pjesë sa më shumë të ftuar në evenimentin e sotshëm. 'PD hap dyert për njerëzit'. Lideri Basha fton të gjithë demokratët në mbarë vendin që t'i bashkohen ditëlindjes së saj. "Ju mirëpresim në shtëpinë tonë me rastin e ditës së themelimit. Qytetarë të Tiranës dhe bashkëbisedim me shkrimtarë dhe intelektualë". Përvjetori i 28 i PD-së sivejt është konceptuar disi më ndryshe nga herë të tjera, ndërkohe që është ndryshuar edhe vendi ku do të zhvillohet aktiviteti festiv. Vitet e mëparshme, demokratët mblidheshin në hollin e Pallatit të Kongreseve ndërkohe që sot do të mblidhen në ambientet e selisë së Partisë Demokratike. Festa është konceptuar me filma dokumentarë, më pas do të vijojë në bashkëbisedim me shkrimtarë dhe intelektualë. Eventimenti do të vijojë me një ekspozitë nga artistët e rinj, si dhe do të ketë performancë nga aktorë të njohur.

FTESAT

Lufta politike nuk e kufizon Partinë Demokratike të ftojë përfaqësuesit e rivalës së saj, Partisë Socialiste në 28-vjetorin e themelimit. Selia blu ka adresuar ftesa për të gjitha partitë politike në vend duke mos përjashtuar as një ftesë për socialistët. Ftesa e PD-së i është adresuar grupit



AXHENDA

Si çdo 11 dhjetor, edhe sot demokratët do të kujtojnë gjenezën për të nderuar protagonistët e atyre ditëve që bënë histori. Në 28-vjetorin e themelimit do të organizohet një ceremoni festive. Ndryshe nga herë të tjera, demokratët do të mblidhen pasditën e sotme në selinë e partisë përgjatë dy orëve nga ora 18:00-20:00.

"PD nuk po kuptohet nga populli"

Hajdari: Një parti s'shkon dot në fitore me thirrje nacionaliste

Deputetja e PD-së, Rudina Hajdari, vajza e Azem Hajdarit ka deklaruar se nuk tërhiqet nga vendimi e saj për të lënë mandatin. Në një status në 'Facebook', Hajdari kritikon PD-në teksta shprehur se kjo forcë politike nuk kuptohet nga populli dhe se nuk sheh të ardhme brenda saj. Sipas deputesës së PD, një parti politike s'mund të shkojë kurrë në fitore me fotografi apo me thirrje nacionaliste. Ajo bën të ditur se ditë do kon-sultohet me personat që e kanë votuar dhe më pas do të japë dorëheqjen nga mandati i saj. "E kam vësh-tirë të shikoj një të ardhme brenda një partie që po duket sikur po nuk po kuptohet nga populli gjithsesi. Një parti nuk sh-



kon dot kurrë në fitore, as me foto me figura të larta politike, dhe as me thirrje nacionaliste. Flas këtu për dësh-timin e të gjitha partive, sepse këto janë rrugët që po ndjekin për të shpëtuar veten. Partia e Lëvizjes Socialiste për Integrim e bëri punën e saj dhe i shërbeu Ilir Metës deri në ngritjen dhe ringar-tijen e tij. Tani kjo organiza-

të është pa udhëheqje, por me përfaqësimit. Ndërkohë, Partia Socialiste është në prag të vetëvrasjes politike. BE-ja është e lodhur me të dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara nuk i beson më askujt. Pra, jemi në një udhëkryq të madh", deklaroi zj.Hajdari. Megji-thatë, shton ajo para se të heq dorë nga mandati im, kam detyrim ndaj atyre që më qëndruan pranë gjatë kësaj kohe, ndaj atyre që më votuan. "Do të takohem me ta, dhe do ta diskutoj me ta vendimin tim, sepse ndjej detyrim madhor ndaj tyre. Pra, ky është vendimi im, dhe janë studentët e sotëm që më frymë-zuan të ndër-marr këtë hap. Prandaj them që nuk ka kthim mbrapa"-shkruan Hajdari.

Mediu zgjidhet anëtar i Komitetit Drejtues për Sigurinë në Kongresin e USA

Kreu republikan, Fatmir Mediu gjatë vizitës në SHBA është zgjedhur si anëtar i Komitetit Drejtues në Forumin Parlamentar të Inteligjencës dhe Sigurisë në Kongresin Amerikan. Ky propozim është bërë nga Kongresmeni Robert Pittinger dhe është pranuar nga Fatmir Mediu. "Ky komitet zhvilloi takimin e parë mbas forumit në një mëngjes pune në University Club me përbërje nga kongresmenë, anëtarë të Bundestagut Gjerman, parlamentit Europian dhe parlamentarë të disa vendeve, por dhe përfaqësues të industrisë dhe teknologjisë Amerikane. Gjatë fjalës në Forum jo vetëm theksova vlerën e bashkëpunimit në këto forume të rëndësishme, por dhe nevojën e çdo vendi që mbështetur në konkluzionet dhe rekomandimet e Forumit të angazhohet në miratimin dhe implemen-timin e ligjeve. Po ashtu dhe nevojën e bashkëpunimit me Forumet e tjera të sigurisë veçanërisht në Europë", tha z.Mediu. Kreu republikan njofton në "Facebook" se "folësit kryesorë të këtij forumi ishin përfaqësues të lartë të Senatit si Lindsey Graham, Senatori James Lankford, Kryetarët e komisioneve të Kongresit, përfaqësues të lartë të administratës Amerikane. "Ky forum i lartë ndërko-mbëtar për sigurinë, ofron mundësinë për dialog në lidhje me sfidat aktuale të sigurisë si ajo kibernetike; luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit", -tha z.Mediu.



FORUMI

"Ky forum i lartë ndërkombëtar për sigurinë ofron mundësinë për dialog në lidhje me sfidat aktuale të sigurisë si ajo kibernetike, luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit", -tha z.Mediu.

ofron mundësinë për dialog në lidhje me sfidat aktuale të sigurisë si ajo kibernetike; luftën kundër terrorizmit, asistencë ligjore për të parandaluar ,financimin e terrorizmit, bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit", -tha z.Mediu.

ksandër Meksi, ish-kreun e PD-së Eduart Selami. Një vit më parë gjatë fjalës së tij para demokratëve, kreu Lulzim Basha nuk harroi te përmendte edhe ata që sot ndajnë qëndrime të ndryshme me të. Si themeluesit e Partisë Demokratike ashtu edhe kundërshtarët e kryetarit e bojkotuan festën megjithëse kishin marrë të gjitha ftesa. Në festë është i ftuar edhe Besnik Mustafaj dhe Preç Zogaj, ish-student të PD-së dhe ish-student të dhjetorit. Gjithashtu, në aktivitetin festiv janë të ftuar edhe familjarët e Sokol Olldashit dhe Azem Hajdarit.

PROJEKTLIGJI POLICIA

Kalimi i anëtarëve të FA në radhët e policisë do bëhet duke ruajtur gradat

Propozimi i Lleshajt: Ushtarakët mund të bëhen pjesë e policisë

Shoqata e policëve del kundër nismës së ministrit

Nëse je një ushtarak aktiv apo në lirim mund të bëhesh edhe polic apo drejtues i saj. Ministria e Brendshme ka hartuar disa ndryshime në ligjin "Për policinë", ku ndër të tjera ka propozuar edhe një dispozitë të veçantë, që ka të bëjë me mundësinë që për nevojat e veçanta të forcave të rendit mund të marrë efektive apo ushtarakë që të bëhen pjesë e Policisë së Shtetit. Propozimi është ende në fazën e një drafti dhe nuk është miratuar ende në qeveri, ndërsa parashikohet që kalimi i ushtarakëve në radhët e policisë të bëhet në bazë të një marrëveshjeje mes dy ministrive, asaj të Mbrojtjes dhe asaj të Brendshme.

PROJEKTLIGJI

Projektligji në fjalë parashikon që në ligjin ekzistues të Policisë së Shtetit të përfshihet një nen i posaçëm për pranimin në Policinë e Shtetit nga radhët e Forcave të Armatosura. Kështu, projektligji përcakton që për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kjo ka të bëjë kryesisht me ushtarakët e nxjerrë në lirim, pasi në këtë nen ka një dispozitë të veçantë posaçërisht për ushtarakët e shërbimit aktiv, pranimi i të cilëve do të realizohet mbi bazën e marrëveshjes dypalëshe ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, ku përcaktohen kuotat dhe strukturat nga ku do të pranohen. Ndërsa për ushtarakët e nxjerrë në lirim, pranimi do të realizohet mbi baza konkurrimi, procedurat e të cilit përcaktohen me udhëzimin të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike. Në të dyja rastet, pra si për ushtarakët aktivë, ashtu edhe ata në lirim, kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura të Policia e Shtetit do të realizohet duke njohur e ruajtur vjetërsinë e shërbimit. Por jo vetëm kaq, ata do mund mbajnë edhe gradat, ndërsa Këshilli i Ministrave me porosi të ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike do të miratojë ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me gradat e Policisë së Shtetit.

FISHTA

Propozimi i ministrit Sandër Lleshaj për të përfshirë edhe ushtarakë në radhët e policisë shihet me skepticitëz nga përfaqësues të Sindikatës së Policisë. Ata thonë se kjo nismë mund të dëmtojë hierarkinë që është krijuar për vitet me radhë në policinë e shtetit. "Nëse ligji miratohet do të ketë dyndje



Foto ilustruese

PROJEKTLIGJI/ PAS PIKËS 2, SHTOHET PIKA 3 ME KËTË PËRMBAJTJE:

"Për nevojat e Policisë së Shtetit pranohen në Akademinë e Policisë shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij. Kandidati që përfundon me sukses kualifikimin përkatës, pranohet në Policinë e Shtetit dhe i jepet grada policore nënkomisar".

Ministria Gjonaj, thirrje gjyqtarëve dhe prokurorëve: Zgjidhni KLGJ dhe KLP

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka paralajmëruar se në vitin 2019 do të ketë ndëshkime për të gjithë ata zyrtarë të lartë të shtetit që abuzojnë me detyrën. Në rolin e koordinatores Kombëtare Anti-korrupsion, Gjonaj bëri bilancin e një viti pune në krye të kësaj njësie gjatë një konference të përbashkët me ambasadorin e BE-së, Luigi Soreca. Ndërsa prezantoi arritjet dhe rezultatet në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në vitin 2018, Gjonaj siguroi shqiptarët se vitin 2019 do të jetë vendimtar dhe sinjifikativ për të shënuar më shumë rezultate në lidhje me luftën kundër korrupsionit. "Ng-



ritja e institucioneve të reja të drejtësisë si mekanizma që do të garantojnë edhe ndëshkimin e zyrtarëve të lartë të përfshirë në çështje korrupsioni do të jetë një hap shumë i rëndësishëm, që do të ndihmojë në rifitimim e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe do të shënojnë një gur themeli në luftën kundër korrupsionit", tha Gjonaj. Ajo u bëri thirrje gjyqtarëve dhe prokurorëve që të bëhen pjesë e procesit për të

zgjedhur anëtarët e rinj të KLGJ-së dhe KLP-së, si dy institucione që do të çonin edhe në nivel më të zbatimit e reformës në drejtësi. "Inkurajoj të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët të marrin pjesë në mbledhjet e përgjithshme respektive, për të ushtruar detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në zgjedhjen e kandidatëve të KLGJ dhe KLP. Inkurajoj dhe nxis edhe drejtuesit e mbledhjeve të përgjithshme respektivisht për gjyqtarë dhe prokurorë për të garantuar një proces të drejtë, transparent, të qetë për t'u treguar qytetarëve se gjyqtarët dhe prokurorët kanë kurajë për zbatimin e reformës në drejtësi", - u shpreh ministria.

të ushtarakëve që do të synojnë postet drejtuese në Policinë e Shtetit, përfshi edhe atë të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por e njëjta gjë do të ndodhë pastaj edhe me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit", tha Sadetin Fishta, kreu i

Sindikatës së Policisë për "Klan". Një tjetër shkelje për Fishtën është edhe ekuivalentimi i gradave mes ushtarakëve dhe punonjësve të policisë. "Kjo është hera e tretë që kërkohet ndryshim për Ligjin e Policisë së Shtetit, edhe pse kemi akoma akte nën ligjore

të miratuara në vitin 2014 që nuk kanë hyrë ende në fuqi. Pranimi i ushtarakëve në polici është një hap mbrapa. Nëse do miratohet ky nen, do të krijohet klimë tjetër ku do jetë një polici ushtarako-policore që jo një polici që do i shërbejë komunitetit", tha Fishta.

FISHTA

"Nëse ligji miratohet, do të ketë dyndje të ushtarakëve që do të synojnë postet drejtuese në Policinë e Shtetit, përfshi edhe atë të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por e njëjta gjë do të ndodhë pastaj edhe me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit", tha Sadetin Fishta.

Ministri Lleshaj në "A Show": Pjesë e PS? S'bëj plane të gjata

Ministri i ri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, emërimi të cilit solli debate dhe përplasje me Presidencën dhe Kryeministrinë u bë dje pjesë e emisionit "A Show" në "News 24". Në një intervistë friballë Adi Krastës, Lleshaj foli për detyrën e tij të re, si dhe risitë që pritet të ketë Policia e Shtetit. Pyetjes nëse ka një plan që pas mbarimit të këtij mandati, të fillojë një jetë politike të hapur' te PS, ministri iu përgjigj: "Përgjithësisht nuk bëj plane të gjata personale. Mendohem të bëj plane të gjata institucionale, për institucionin ku unë punoj, që të jem sa më strategjik dhe largpamës. Në aspektin personal, preferoj që mos të bëj plane të gjata. Unë kam shumë gjëra një force tjetër, që besoj se na udhëheq në jetën tonë. Si'i bëj këto planet personale të madhe".



SHBA: Zgjedhja e KLGJ dhe KLP, hap drejt hapjes së negociatave

Ambasada amerikane në Tiranë përmes një postimi në faqen zyrtare në "Facebook" u bëri thirrje dje gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë që të sigurojnë një proces të lirë dhe transparent zgjedhor për magjistratët në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë të Gjyqësor, që do të mbahet sot dhe nesër. "Ne u bëjmë thirrje gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë që të sigurojnë një proces të lirë dhe transparent zgjedhor për magjistratët në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë të Gjyqësor. Ngritja e vazhdueshme e institucioneve së reformës në drejtësi duhet ruajtur dhe konfirmuar këtë javë. Kjo është mundësia që gjykatësit dhe prokurorët t'i japin kontribut dhe formë sistemit shqiptar të drejtësisë për të ardhmen dhe shpresat e të gjithë shqiptarëve. Ne presim që ata të tregojnë se kanë zotërim dhe përgjegjësi në krijimin e këtyre institucioneve jetike", shprehet ambasada e SHBA-ve. Ajo thekson se ruajtja e këtij progresi, sidomos nëpërmjet krijimit të strukturave gjyqësore të pavarura të parashikuara në reformën kushtetuese është një hap thelbësor drejt rrugës së çeljes së negociatave me Bashkimin Europian në qershor 2019.

Përfundojnë hetimet ndaj grupit kriminal, ja pretenca për trafikantët italianë

Trafiku i drogës Shqipëri-Itali, prokuroria e Katanias kërkon 18.8 vite burg për Moisi Habilajn

Kërkohet 12.4 vite burg për Meridjan Sulajn, 6 vite për Nazer Seitin dhe lirimi i Fatmir Minajt

ITALI

Prokuroria e Katanias në Itali ka kërkuar dënimin me 18 vite e 8 muaj për Moisi Habilajn, i konsideruari si kreu i grupit kriminal "Habilaj", që trafikonte tonelata me kanabis nga Vlorë drejt vendit fqinj. Prokurori i çështjes, Antonio Bonomo, dje ka lexuar pretencën për të pandehurit që u arrestuan gjatë operacionit të koduar "Rosa dei venti" ose "Trëndafilat e erës", mes të cilëve është dhe Moisi Habilaj. Media italiane "Meridionews" shkruan se prokurori Antonio Bonomo kërko dënimin më të lartë për kushërinin e ish-ministrit të Brendshëm shqiptar, Saimir Tahiri. Për lidhje me Habilajn, në Shqipëri po hetohet edhe ish-ministri Saimir Tahiri, i cili përgjatë gjithë kohës i ka hedhur poshtë akuzat ndaj tij. Ndërkaq, mësohet se Prokuroria e Katanias ka kërkuar gjithashtu dënimin me 12 vite burg e 4 muaj për Meridjan Sulajn si dhe 6 vite heqje lirie për "financierin" e Habilajve, Nazer Seitin. Ekstradimi i këtij të fundit krijoi përplasje dhe akuzat mes mazhorancës dhe opozitës në Tiranë. Ndërkohë që prokuroria ka kërkuar lirimin nga akuzat për Fatmir Minajn. Në pretencën e dhënë nga prokurorët e Katanias rezultoi se kërkesa me më shumë vite burg është për Moisi Habilajn, ndërsa nuk mbeten pas edhe trafikantët italianë, që kanë përfunduar në pranga si pjesë e këtij grupi. Konkretisht, për Antonio Riela, aktualisht i ndaluar, prokurori ka kërkuar dënimin me 15 vite burg, për Angelo Busaçka ka kërkuar 8 vjet, për Gianluca Spampinato, 10 vjet e 4 muaj, për Gianluca Passavanti, 4 vjet dhe 20 mijë euro gjobë. Ndaj William Patané, Fabio Spampinato, Carmelo Bertolini, Enrico Maria Giaquinta, Antonio Greco, Giuseppe Greco dhe Rosario Giuliano 2 vjet e 4 muaj dhe 6 mijë euro gjobë. Nga ana tjetër bëhet me dije se vitet e burgut, kërkuar nga Prokuroria e Katanias në rast të një dënimi nga gjykata pritet të përgjysmohen, pasi ky proces në Itali është zhvilluar me gjykim të shkurtuar. Moisi Habilaj rezultoi se ka qenë i pranishëm në çdo shtet gjyqësorë që është zhvilluar ndaj tij në Gjykatën e Katanias, ndërsa sipas raportimit të mediave lokale, ai për gjatë gjithë kohës ka



Moisi Habilaj

PRETENCA E PROKURORISË SË KATANIAS

■ TRAFIKANTËT SHQIPTARË

1. Moisi Habilaj, 18.8 vite burg
 2. Meridjan Sulaj, 12.4 vite burg
 3. Nazer Seitin, 6 vite burg
- Fatmir Minaj, të lihet i lirë

■ TRAFIKANTËT ITALIANË

1. Antonio Riela, 15 vite burg
 2. Gianluca Spampinato, 10.4 vite burg
 3. Angelo Busaçka, 8 vite burg
 4. Gianluca Passavanti, 4 vite burg dhe 20 mijë euro gjobë
- Ndaj William Patané, Fabio Spampinato, Carmelo Bertolini, Enrico Maria Giaquinta, Massimiliano Brundo, Antonio Greco, Giuseppe Greco dhe Rosario Giuliano 2.4 vite burg dhe 6 mijë euro gjobë.

qëndruar i heshtur. Për grupin "Habilaj" janë duke u kryer hetime edhe nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ndërsa janë vendosur nën sekuestro preventive miliona euro pasuri, mes tyre apartamente dhe biznese në pronësi të familjes Habilaj. Sipas burimeve nga autoritetet italiane, ky grup furnizonte me kanabis zonat e Katanias, Sirakuzës dhe Raguzës në Itali, ndërsa në Shqipëri rezultoi se Habilajt kishin edhe përkrahjen e policisë lokale të Vlorës, duke

shmangur kontrollin si gjatë trafikimit me peshkarexha apo gomone edhe gjatë kultivimit në parcela që nuk asgjësoheshin. Sipas mediave italiane, organizata kryente trafikun e drogës kryesisht nga deti me anë të anijeve të peshkimit.

VENDIMI I KATANIAS PËR TAHIRIN

Drejtesia italiane në Katania me një vendim të datës 5 tetor të këtij viti ka vendosur mbylljen e hetimit ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Janë pikë-

risht këto vendime, kërkesa e Prokurorisë së Republikës Italiane dhe vendimi i Gjykatës së ish-ministrit të Brendshëm dorëzoi dje në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Sipas dokumenteve të siguruarra më 15.03.2018, në përfundim të hetimeve që zbatën thuajse 5 muaj, Prokuroria e Antimafies në Itali i ka kërkuar Gjykatës Italiane të mbyllë hetimet për Tahirin me arsyetimin se, "nuk ka element të përshatshëm për të mbështetur akuzën". Megjithatë nuk ka dëshmi mbi përmendjet e bëra nga Habilaj Moisi gjatë përgjimeve, veçanërisht ku për mend se duhet t'i japë 30.000 euro një "Saimir" ose në pjesët ku flet për berjen e disa bizhuterive për bashkëshorten dhe të ëmën e Saimir Tahirit, në vlerësimin e prokurorisë, në mungesë të përgjigjeve të vlefshme nuk ekzistojnë elementet e vlefshëm për të ngritur akuzë në gjyq", thuhet në deklaratën e prokurorit të antimafies italiane. Në 19.03.2018, vetë Prokurori i Republikës konfirmoi kërkesën e Prokurorit të Antimafies për mbylljen e hetimeve ndaj Tahirit, duke i hapur rrugë kështu vendimit të gjykatës. "Gjykata, duke vlerësuar kërkesën e prokurorit dhe duke pranuar në mënyrë të plotë argumentet e prokurorit, në bazë të nenit

HETIMET PËR GRUPIN "HABILAJ"

Në tetor të vitit që shkoi u godit grupi "Habilaj", që akuzohet për trafik ndërkombëtar droge. Ndërsa, Nazer Seitin u prangos në Vlorë për t'u ekstraduar më pas drejt Italisë. Hetimet në Shqipëri u hapën pas publikimeve në media, ndërsa u morën në Itali me mijëra faqe përgjime të grupit "Habilaj", ku ata përmenden edhe emrin e ish-ministrit Saimir Tahiri.

Sekuestrohen 124 kg marijuanë në 2 operacione, bien në pranga 3 shqiptarë

GREQI - Policia greke ka sekuestruar dje një sasi prej 124 kg marijuanë në dy operacione antidroge në kufirin greko-shqiptar. Operacioni i parë është zhvilluar nga policia greke në Kerasoxori, Igumenicë, ku është ndaluar një mjet që vinte nga kufiri i gjelbër, brenda të cilit u gjetën dhe sekuestruan 100 pako me 105 kg 460 gr marijuanë dhe 1 pistoletë tip "TT". Në pranga ka përfunduar drejtuesi i mjetit, një shqiptar 34 vjeç, të cilit iu sekuestrua edhe një pasaportë shqiptare me vulë hyrëse të falsifikuar, ndërkohë që rezultoi se atij i ishte ndaluar më parë hyrja në zonën Shengen. Mjeti rezultoi i marrë me qira në Greqi. U sekuestruan gjithashtu edhe 2 celularë e 250 euro. Ndërsa, operacioni i dytë u zhvillua në Sajadhe të Igumenicës, ku u sekuestruan rreth 19 kg marijuanë. Autoritetet greke ndaluan një automjet për të cilin nuk u saktësua nëse kishte kaluar nga dogana apo jo, por brenda makinës në një vend të improvizuar enkas në prapakol dhe në portë u gjetën 35 pako. Në pranga përfunduan dy shqiptarë, një mashkull 20 vjeç dhe një femër 33-vjeçare. Në cilësimin e provave materiale u sekuestruan edhe 1 lap top e 1 celular. Për fillimet të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadhë, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aftilokarnania, Patra, Kostur, Grevena, Follorinë, Aleksandroupoli etj. policia greke ka sekuestruar rreth 11 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.



409-411 KPP, vendos mbylljen e hetimit për çështjen të shqyrtim dhe depozitim e akteve pranë prokurorisë". Vendim i cili është marrë Gjykata italiane e Katanias më 5 tetor, bazuar në kërkesën e prokurorit të Antimafies. Ish-ministri i Brendshëm,

Saimir Tahiri është vënë nën hetim nga Prokuroria e Antimafies italiane në dt. 27.10.2017. Me mbylljen e hetimeve në Itali, ish-ministrit të Brendshëm i mbeten të hapura hetimet në Shqipëri, afati i të cilave u shty së fundi deri në janar 2019.

Shoqëria përmbirimore JUSTITIA

Shoqëria përmbirimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e dyte, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka venë hipoteke NBB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji i pasurisë: Aree - Trulli (magazina dy kate) me sip. arë 3000 m2 / trulli 1661/ ndërtesë 234.9, me nr. pasurie 589 vol 8 1676, zik. 1475. Derven, KRUIË në pronësi të Haki Ahmet MAURICQI
Cmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 67.200 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) EUR

Ankand zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbareut gjyqësor, me Adrese: Bulvardi "Bejram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë të pasurisë të palës debitorë Shoqëria "General Polymeren Recycling Albania" sh.p.k. e pabërë nga:

- "ARE", Nr. pasurie 3153, nr. Z. K. Nr. 225, volum nr. 5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, në Koxhas, Durres. Ankand i pasurisë fillon me cmimin filluesar në masën 163.615, 7 Euro.

- "ARE", Nr. pasurie 3114, nr. Z. K. Nr. 225, volum nr. 1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12 900 m2, në Koxhas, Durres. Ankand i pasurisë fillon me cmimin filluesar në masën 300.105, 6 Euro.

- "ARE", Nr. pasurie 313, Z. K. Nr. 225, volum nr. 1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4 200 m2, në Koxhas, Durres. Ankand i pasurisë fillon me cmimin filluesar në masën 100.035, 2 Euro.

Ankand do të zhvillohet në datë 24.12.2018 prej orës 15:00 në selinë: Bulvardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakti tel. 00355672082543 ose në faqen WEB www.powerjustice.al

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567.568 e vijues të K.P.C shpall ankandin e parë për pasurinë e palës debitorë Sh"Strati Construccon" sh.p.k. - K. Strati dhe L. Strati. Pasuria përbehet nga:

- "Ara", Nr. pasurie: 17223 rindohur në Drag dhe Durres, Z. K. Nr. 1522, volum 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1 000 m². Ankand fillon me cmim filluesar në masën 2 200 000 lekë

- "Apartment", Nr. pasurie: 11645-1-19 në Kryemadhe Kavajë, Z. K. Nr. 2291, volumi 22, faqe 42, me sipërfaqe 33.19 m².

- "Apartment", Nr. pasurie: 11645-1-20 në Kryemadhe Kavajë, Z. K. Nr. 2291, volumi 23, faqe 43, sipërfaqe 59.24 m² dhe Ankand fillon me cmim filluesar në masën 2 720 000 lekë

Ankand qendron i hapur 15 ditë dhe do të zhvillohet në datë 24.12.2018 në orën 15:00 në Bulvardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të llogarë dokumentacionin të kontaktit me tel. 00355 47 82 543 ose e-maili ll.demishtaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice.al

SIGURIMI PER FERMERET AMNISTIA

Hasan Hoxha: Ka raste të tokës pa dokumente dhe disa kritere ligjore të paplotësuara

Eksperti: Skema e kontributeve të fermerëve, edhe efekte negative në fushën e përfitimeve

"Kontrollet jo gjithnjë i kanë zgjidhur problemet"

Voltiza Duro

Problemet në skemën e kontributeve të të vetëpunësuarve në bujqësi janë shoqëruar edhe me efekte negative në fushën e përfitimeve. Në një intervistë ekskluzive për Gazeta Shqiptare, ish zv/drejtori i përgjithshëm i ISSh-së, prof.as.dr. Hasan Hoxha tregon profilet në të cilat paraqitet struktura e përfitimeve brenda skemës. Eksperti thekson se një pjesë e përfitimeve (sado e vogël të jetë ajo) bie ndesh me kriteret ligjore të përcaktuara. Hoxha e vlerëson si të paarsyeshme situatën aktuale për këtë pjesë të përfitimeve, e shprehet se ekzistojnë tre opsione për zgjidhjen e situatës. Edhe pse pranon se ekzistojnë disa opsione për rrugëzgjidhjen ligjore, ai thekson se zgjidhja më e mirë dhe më e arsyeshme është amnistia.

Në intervistën e një dite më parë për "Gazeta Shqiptare", ju keni folur për kontributet me probleme për të vetëpunësuarit në bujqësi. A kanë ndikime këto në fushën e përfitimeve?

Në vijim të intervistës për nevojën dhe arsyet e ndryshimeve ligjore të skemës, po shprehemi edhe për nevojën e një amnistie të përgjithshme të kontributeve të paguara nga fermerët, me statusin e të vetëpunësuarve në bujqësi. Fillimisht pohojmë se, pavarësisht nga problemet në fushën e kontributeve, pavarësisht nga shkalla informale e pagesës, e dalë në sipërfaqe apo dhe e "fshetur", skema e të vetëpunësuarve në bujqësi, në më shumë se 20 vite, periodikisht ka prodhuar përfitime, ndërsa edhe për të ardhmen, ka krijuar potencialisht një kontingjent jo të pakët përfituesish. Patjetër që këto mangësi në kontribute janë shoqëruar me efekte negative, do të thosha, edhe sa i përket përfitimeve. Kështu, sipas qëllimit, struktura e përfitimeve paraqitet me profile nga me të ndryshmet.

Cilat janë disa prej profileve që paraqitet struktura e përfitimeve?

Në raport me ligjshmërinë që është dhe në përgjigje të pyetjes suaj, mund të veçonim disa. Së pari, përfitime që rrjedhin nga kritere ligjore të sakta (të kuptimita), të cilat mbështeten në zbatimin e kriterëve ligjore të vend-



Eksperti, Hasan Hoxha

PROBLEMATIKAT

E gjithë kjo fushë, me këtë ndërthurje të kriterëve, me pasaktësi në formulimin fillestar të tyre, veçanërisht, duke i anashkalluar ato gjatë zbatimit, ka krijuar një kontingjent jo të pakët të qytetarëve që përfitimet ose i marrin jashtë zbatimit të kriterëve ligjore, ose përballen me strukturat e sigurimeve shoqërore, me mosnjohje të kontributeve të paguara, me moscakim të pensioneve, ose me cakimin e pjesshëm të tyre.

sura pra, në tokën e përfituar apo të disponuar në rrugë ligjore, në aktivitetin e qenësishëm bujqësor, si dhe përfitime për të cilat kamatëvonesat për kontribute jashtë afateve, janë paguar sipas legjislacionit përkatës. Ky grup i të vetëpunësuarve në bujqësi, që sigurisht, përbën dhe pjesën më të madhe, cilësohen me përfitime të rregullta, pasi ato janë sipas legjislacionit të projektuar. Së dyti, mund të përmendim përfitime të caktuara, ose potencialisht të krijuara, që mbështeten në kontribute të paguara veçse, me probleme për sa i përket praktikës së zbatimit të kriterëve. Pra, herë me tokë pa dokumente, ose me dokumente pa tokë apo, shpesh me sipërfaqen e tokës në madhësinë e një trualli; me sipërfaqen e tokës brenda garkut ku fermeri banon, por, dhe me banim në qytete ose, jo në nënqarkun fqinj; me sipër-

faqen e tokës në pronësi veçse pa aktivitet bujqësor, por që vërtetohet si i tillë; me kamatëvonesat të papaguara kur në ligj parashikimi është ndryshe. Përfitime të kësaj kategorie, pavarësisht peshës specifike të tyre, janë dhënë e jepen nga strukturat e pensioneve edhe pse, në përmbajtje, ato bien ndesh me kriteret ligjore të përcaktuara. Ato mbështeten në vërtetimet kontributeve të lëshuara nga dega përkatëse, ndërsa të dhënat për pronësinë mbi tokën, për veprimtarinë bujqësore apo për pagesën e kamatëvonesave, ato qëndrojnë "të fshehura" në dosjen që çelet për fermerin kontributpagues.

Brenda strukturës së përfitimeve, a ka përfitime të pakualifikuara?

Po, ka edhe përfitime që nuk kualifikohen, pra përfitime që nuk janë caktuar dhe nuk caktohen edhe pse kontributet janë paguar nga

të vetëpunësuarit në bujqësi. Në këtë grup përfitimesh që nuk kualifikohen, cilindo qoftë numri i tyre, mund të ketë ndonjë tjetër arsye, por të vetmen arsye penguese që kam konstatuar, është ajo e mospërputhjes së tokës me vendbanimin sipas certifikatës së gjendjes civile. Ky kontingjent nuk ka arritur që kontributet t'i paguara në harmoni me këto dy kritere ligjore. Po themi, ose i kanë nënvlerësuar, ose nuk kanë njohur rëndësinë e këtij problemi. Edhe për këtë kategori, në dosjen e të vetëpunësuarit ka dokumente, veçse në dosjen e pensionit vendndodhja e tokës sipas certifikatës së pronësisë nuk përputhet me vendbanimin sipas certifikatës së gjendjes civile. Kësisoj, në të dy grupimet e mësipërme të përfituesve, brenda tërësisë së tyre por, edhe për të njëjtin person, për shkak të problematikës në kontribute, ekzistojnë një simbiozë e kriterëve të respektuara me mosrespektimin e tyre, një simbiozë midis përfitimeve të ligjshme dhe atyre që konsiderohen me shkelje ligjore. Madje, për të njëjtat kritere të paplotësuara, gjenden bashkë edhe përfituesit e kategorizimit të dytë të mësipërm, edhe

fermerët që përjashtohen nga përfitimi, për shkak të "rënies" së kontributeve.

PERFITIME TE PAKUALIFIKUARA

Po, ka edhe përfitime që nuk kualifikohen, pra përfitime që nuk janë caktuar dhe nuk caktohen edhe pse kontributet janë paguar nga të vetëpunësuarit në bujqësi. Në këtë grup përfitimesh që nuk kualifikohen, cilindo qoftë numri i tyre, mund të ketë ndonjë tjetër arsye, por të vetmen arsye penguese që kam konstatuar, është ajo e mospërputhjes së tokës me vendbanimin sipas certifikatës së gjendjes civile.

fitimeve, ku gjenden bashkë zbatimi i ligjit me të kundërtën e tij, ku përfitimet e drejta bashkëtojnë me ato që nuk justifikohen nga pikëpamja e së drejtës, ku një pjesë e fermerëve penalizohen, ndërsa pjesa më e madhe e "kalon" pengesën duke marrë përfitime, shumëkush mund të thotë që, të gjithë kontributet e paguara të certifikohen, duke u kontrolluar ar mënyrë zbatimi ose jo i kriterëve ligjore. Kjo do kërkonte një proces të plotë e të thellë auditimi, duke kontrolluar çdo lloj dokumenti në dosjen e secilit prej të vetëpunësuarve, duke i "përpasur" këto vërtetime që ka dosja me gjendjen reale të tyre në praktikë.

Çfarë do të sillte sipas jush ky proces i thellë auditimi?

Sipas këtij varianti, për shkak të kohës së gjatë nga funksionimi fillestar i kësaj skeme, për shkak të një skeme në lëvizje e zhvillim të vazhdueshëm, si dhe për shkak të të tjerë faktorëve, sipas mendimit tim, do të rrezoheshin një numër i madh përfitimesh, krahasuar me një numër tjetër kontributeve po ashtu, me shumë pasoja sociale dhe ekonomike për "viktimitat" e këtij procesi.

A mund të ketë përmirësime, nëse situata qëndron kështu, siç është aktualisht?

Është dhe opsioni që situata të qëndrojë kështu, ajo të zhvillohet e të riprodhohet në të njëjtat kushte si deri më sot, në pritje të përmirësimeve të vetvetishme që mund të merren nga një proces i ardhshëm ligjor i plotë që saktëson pronësinë mbi tokën bujqësore, apo nxjerr në pah shfrytëzimin e vërtetë të saj për qëllime bujqësore. Të jesh i këtij varianti, kjo do të thotë që situata aktuale të mos ndryshojë, do të thotë të certifikohen ligjërisht përfitimet e padrejta, të certifikohen veprimet e padrejta të ndonjë individi apo strukture të sigurimeve shoqërore, të cilat një pjesë të të vetëpunësuarve e kanë përjashtuar nga e drejta për përfitime, ndërsa pjesën tjetër jo.

Cilat janë pasojat e problematikave të sipërpërmendura?

E gjithë kjo fushë, me këtë ndërthurje të kriterëve, me pasaktësi në formulimin fillestar të tyre, veçanërisht, duke i anashkalluar ato gjatë zbatimit, ka krijuar një kontingjent jo të pakët të qytetarëve që përfitimet, ose i marrin jashtë zbatimit të kriterëve ligjore, ose ata përballen me strukturat e sigurimeve shoqërore, me mosnjohje të kontributeve të paguara, me moscakim të pensioneve, ose me cakimin e pjesshëm të tyre. Shumë prej tyre sorollaten nga degët e përfitimeve, përshihen me dashje ose jo në Komisionet e Ankimit, të cilët zgjatën me disa muaj. Ndërsa, pjesa dërrmuese e tyre, si pa të keq, përfundojnë në procese gjyqësore, në të cilat beteja ende vazhdon shumë gjatë, ndërkohë që, për shumicën e kontributpaguesve të kësaj kategorie, vendimet e gjykatave vijojnë të jenë negative.

Atëherë, si kapërcëhet kjo "simbiozë" e pajustifikuar në përfitime, apo pamundësia e marrjes së tyre për të tjerët?

Përballë kësaj situatë të paarsyeshme në fushën e për-

Eksperti Hasan Hoxha: Shmangen rastet abuzive në kontribute dhe përfitime

Pse duhen amnistuar kontributet e paguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi

"Do të unifikohet për të gjithë fermerët sjellja ligjore"

Voltiza Duro

Zgjidhja më e mirë për t'i dhënë fund problematikave të krijuara në strukturën e përfitimeve, është një amnisti e përgjithshme për kontributet e paguara në bujqësi. Ky opsion vjen nga eksperti i sigurimeve shoqërore, Hasan Hoxha, i cili në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se kjo amnisti konsiston në njohjen e kontributeve të paguara për krejt periudhën, pra edhe për ato të paguara pas vitit 2005. Argumentet në favor të këtij zhvillimi janë disa, si të natyrës sociale dhe asaj organizative. Hoxha thekson se amnistia për të gjithë kontributet e paguara, do të shmangë mjedisin e favorshëm të krijuar për abuzime dhe korrupsion, në fazën e caktimit të përfitimeve apo në fazën e vendimmarrjes për to.

Sipas mendimit tuaj, si mund t'i jepet zgjidhje problematikave në strukturën e përfitimeve?

Sipas gjykitimit tim, rruga më e arsyeshme e zgjidhjes së kësaj situatë, do të ishte aplikimi i një amnistie të përgjithshme të kontributeve të paguara në bujqësi, ose ndryshe, njohja e kontributeve të paguara për krejt periudhën, pra edhe për ato të paguara pas vitit 2005. Çdo kontribut i paguar, i përfshirë në databasën e të dhënave të ISSH-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, të Këshillit të Ministrave, të konsiderohet i mirëqenë pra, të shpallet vlefshmëria e plotë e tij.

Çfarë do të sillte ndryshe aplikimi i amnistisë së përgjithshme të kontributeve të paguara në bujqësi?

Argumentet në favor të këtij zhvillimi janë disa, ato janë të natyrës sociale dhe asaj organizative. Nga pikëpamja sociale, kështu, më së pari, unifikohet për të gjithë fermerët sjellja ligjore për kontributet e paguara, pavarësisht vendit dhe kohës së pagesës, pavarësisht sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi apo në përdorim, si dhe dokumentet që e provojnë atë; pavarësisht shfrytëzimit dhe nivelit të veprimitarisë bujqësore; pavarësisht nga pagesa ose jo e kamatëvonesave ndër vite, për periudhat, pjesë e detyrimit ligjor. Së dyti, përmes amnistisë, kontingjenti që sot e në të ardhmen, vazhdon të penalizohet, çlirohet nga kjo ngarkesë, ai vjen në të njëjtat kushte përfitimi me pjesën tjetër, e cila këto lloj krijtesh i ka ose të paplotësuar, ose të plotësuar me kushte informale. Në anën tjetër, unifikohen edhe diferencat në qëndrime që shfaqen te të njëjtët persona, të cilët para vitit 2005, ndonëse me kritere jo të

PROBLEMATIKAT

Sipas gjykitimit tim, rruga më e arsyeshme e zgjidhjes së kësaj situatë do të ishte aplikimi i një amnistie të përgjithshme të kontributeve të paguara në bujqësi, ose ndryshe, njohja e kontributeve të paguara për krejt periudhën, pra edhe për ato të paguara pas vitit 2005. Çdo kontribut i paguar, i përfshirë në databasën e të dhënave të ISSH-së, me vendim të Këshillit të Ministrave të konsiderohet i mirëqenë, pra të shpallet vlefshmëria e plotë e tij.



FAVORIZIMI I PROCESIT

Ashtu siç i përshkrova, shkaqet e mësipërme do t'i konsideroja të përmbajtjes së skemës së të vetëpunësuarve në bujqësi. Por, në fazën e tanishme të shtrirjes së saj, procesin e amnistisë e favorizojnë edhe disa mundësi të krijuara, kohe pas kohe. Së pari, skema tashmë, konsiderohet e informatuar dhe në procesin e saj të amnistimit nuk mund të ketë ngarkesa negative, për të shtuar artificialisht numrin e kontributpaguesve.

AMNISTIA

Një çlirim nga ngërçi i krijuar për një auditim të thelluar të këtij procesi, i pakolauduar mirë nga pikëpamja e kritereve ligjore, siç kemi shpjeguar edhe në intervistën e një dite më parë. Në këtë kuptim, amnistia për kontributet e paguara i jep përgjigje përfundimtare udhëkryqit të derisotëm, në të cilin është gjendur procesi i auditimit të brendshëm për këtë pjesë të skemës.

Në bujqësi. Në anën tjetër, amnistia për kontributet e paguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi do të zerojë diferencimin që krijon procesi i sotëm i kthimit të lekëve të paguara për një pjesë, ndërsa për pjesën tjetër zbatohet procesi i konvertimit të tyre në periudha sigurimi sipas skemës vullnetare të kontributeve. Praktika që po përdoret, veçse ligjërishit e diskutueshme, po krijon diferencime të paarsyeshme, aq më tepër që ajo përfshin vetëm një kontingjent të caktuar, atë që bie "në rrjetën" e përpunuesve të dosjeve të përfitimeve, apo ndonjëri që rastësisht "kapet" nga ndonjë auditues i veçantë.

Amnistia, veç sa thamë më sipër, është e nevojshme të aplikohet, pasi skema e të vetëpunësuarve në bujqësi, edhe pse me karakter të theksuar social, apo me shumë dobi për fshatin, ndërtimi i saj fillestar nuk ka

qenë i mirë studiuar, por dhe ndryshimet në disa kritere të saj kanë qenë të shpeshta, të pastuduara, të nxitura nga interesa të momentit, më shumë se interesa ligjore dhe financiare ato kanë pasur ngarkesa elektorale të herë pas herëshme.

Cilat janë disa prej mundësive që favorizojnë procesin e amnistisë?

Ashtu siç i përshkrova, shkaqet e mësipërme do t'i konsideroja të përmbajtjes së skemës së të vetëpunësuarve në bujqësi. Por, në fazën e tanishme të shtrirjes së saj, procesin e amnistisë e favorizojnë edhe disa mundësi të krijuara, kohe pas kohe. Së pari, skema tashmë, konsiderohet e informatuar dhe në procesin e saj të amnistimit nuk mund të ketë ngarkesa negative, për të shtuar artificialisht numrin e kontributpaguesve, për të bërë korrigjime e shtesa, siç mund të ishte kjo në siste-

met manuale. Së dyti, në kushtet kur ka ndryshuar kuota e pagesës së kontributeve, kur ajo pas vitit 2015, është me çmimin e vitit koherent, hapësirat për abuzime janë ngushtuar, ato mund të gjenden vetëm në hapësirën që mund të përdoret për t'i përfshirë në grupin e zonës malore, për shkak të çmimit më të ulët të pagesës. Së treti, për shkak se skema aktuale për të punësuarit në bujqësi është në një fazë, e cila nuk po gjeneron shtim të numrit të kontributpaguesve, apo për të shtuar, mirëfilltazi, vitet kontributive në funksion të shtimit të pensionit të pleqërisë. Se katërti, amnistia i kontributeve favorizohet, edhe nga struktura e atyre që paguajnë, pasi ajo gjithnjë e më shumë po shfaqet e deformuar, më shumë për të siguruar përfitime të veçanta, siç mund të jenë përfitimet afatshkurtër, plotësimi i ndonjë kushti ligjor për përfitime, apo kushtet për të siguruar statuse. Për arsye të këtij lloji por jo vetëm, interesi për skemën aktuale ka rënë ose ndryshe, nuk njih më tej zhvillime, shtimi i numrit të kontributpaguesve, si pjesë e misionit, nuk është plotësuar dhe ka ardhur në rënie. Së fundi, arsye tjetër që favorizon amnistinë, është fakti se skema për të vetëpunësuarit në bujqësi mendohet të jetë ndryshe, ndoshta jo duke iu përmbajtur përsëri këtyre kritereve (tokës bujqësore, shfrytëzimit të saj për qëllime bujqësore, apo

pagesës së kamatvonesave). Nga kjo pikëpamje, nuk do të ishte e arsyeshme që në të ardhmen, qytetarët të penalizohen në përfitime duke mos unjohur kontributet e paguara për një skemë që nuk do të ekzistojë më ashtu si më parë.

A nënkupton amnistia për kontributet e paguara një proces më të pastër të auditimit të skemës?

Nuk do ta cilësoja kështu, një proces më të pastër auditimi por, një çlirim nga ngërçi i krijuar për një auditim të thelluar të këtij procesi, i pakolauduar mirë nga pikëpamja e kritereve ligjore, siç kemi shpjeguar edhe në intervistën e një dite më parë. Në këtë kuptim, amnistia për kontributet e paguara, i jep përgjigje përfundimtare udhëkryqit të derisotëm, në të cilin është gjendur procesi i auditimit të brendshëm për këtë pjesë të skemës. Duhet thënë se, e gjithë kjo fushë, deri më sot, ka qenë vetëm objekt i analizave vjetore, ndërsa auditimi i zbatimit të kritereve për të qenë kontributpagues i fushës së bujqësisë, ai pothuajse ka munguar tërësisht. Ndoshta dhe nga fakti se, certifikimi i vërtetimeve që potencialisht janë në dosjen e çdo kontributpaguesi, nuk përplasen me gjendjen në terren të tokës dhe shfrytëzimitin e saj. Një proces i tillë, përveçse i vështirë për t'u realizuar, do të evidenconte probleme të panumërta, penalitete për shumë pjesëmarrës në skemë, apo dhe përgjegjësi institucionale për personat e aktesueshëm në këtë proces kompleks.

"Kërkesa në Viti e Skënderbeut është kolektive dhe me afat kohor 2-3 vjet"

55 të dënuar dhe të paraburgosur në Burrel, letër MD-së: Kërkojmë amnisti të gjerë

"Kushtet e vendosura në amnistinë e propozuar nuk i plotësojmë dot"

Enver Doçi

BURREL

55 të dënuar dhe të paraburgosur në burgun e Sigurisë së Lartë në Burrelit i kanë dërguar një letër Ministrisë së Drejtësisë, në kuadër të "Viti të Skënderbeut". Në letërën e siguruar nga "Gazeta Shqiptare", ata kërkojnë rishqyrtim të kushteve për përfitim të amnistisë pak ditë para fundit të 2018-ës. Firmëtarët e kësaj peticioni shprehen se kushtet e vendosura në amnistinë e propozuar nga Ministria e Drejtësisë janë të tilla që ata nuk i plotësojnë dot. Të burgosurit shprehen më tej se janë dënuar dhe hetuar padrejtësisht, çka sipas tyre ua bën të pamundur që të përfitojnë nga amnistia. Gjithashtu, kërkojnë që amnistia e këtij viti, që është edhe Viti i Skënderbeut të ishte e përgjithshme dhe për një afat kohor 2-3 vjet.

KËRKESA E PLOTË E 55 TË BURGOSURVE

Në të poshtëshënuarit që po vuajmë si të paraburgosur në IEVP Burrel parashtrijmë kërkesën tonë si më poshtë vijon: "Dëgjuam në televizor se Ministria e Drejtësisë ka bërë një propozim për amnisti. Dëgjuam në televizion se Ministria e Drejtësisë ka bërë një propozim për amnisti. Kjo pa dyshim që është e nevojshme dhe e domosdoshme për të gjithë ata që po vuajmë dënimet.


Por, konstatojmë se kushtet që kërkon kjo amnisti nuk plotësohen nga të paraburgosurit dhe të burgosurit, pasi konstatohen se janë dhënë gjykime dhe dënime të padrejta si për drogën, për dhunën në familje, por edhe për vepra të tjera.

Konstatohet se ka pasur padrejtësi si në hetim, po ashtu edhe në gjykimin e çështjeve të ndryshme. Gjithashtu, vërejmë se gjykatat e rretheve Dibër dhe Mat kanë dhënë dënime më të rënda se gjykatat e rretheve të tjera.

Duke u bazuar në çfarë thamë më sipër, mendojmë se kjo amnisti që është parashikuar të jepet, nuk lehtëson asnjë të paraburgosur ose të



Burgu i Burrelit



Faksimile e letres së të burgosurve, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë



Faksimile e të burgosurve që kanë firmosur letren

AFATI

"Vërejmë se gjykatat e rretheve Dibër dhe Mat kanë dhënë dënime më të rënda se gjykatat e rretheve të tjera. Duke u bazuar në çfarë thamë më sipër, mendojmë se kjo amnisti që është parashikuar të jepet, nuk lehtëson asnjë të paraburgosur ose të burgosur. Kërkesa jonë kolektive është që amnistia e këtij viti, që është edhe Viti i Skënderbeut të ishte e përgjithshme dhe për një afat kohor 2-3 vjet", thuhet ndër të tjera në kërkesën e 55 të dënuarve, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

burgosur.

Kërkesa jonë kolektive është që amnistia e këtij viti që është edhe Viti i Skënderbeut të ishte e përgjithshme dhe për një afat kohor 2-3 vjet.

Në njëfarë mënyre, kjo do të ishte një zgjidhje që për mendimin tonë është e paanshme dhe e duhura për kushtet në të cilat ndodhemi.

Kemi besim se Ministria e Drejtësisë do ta marrë në konsideratë këtë kërkesë. Faleminderit për mirëkuptimin", shprehen në letërën e tyre të burgosurit.

30-vjeçari goditi me makinën e tij "Audi" efektivet blu

Policia: Ja kush janë 32 të "fortët" e Elbasanit në arrati, në "listën e zezë" edhe Suel Çela

ELBASAN

Policia e Elbasanit ka publikuar emrat dhe fotot e 32 personave më të kërkuar në këtë qark dhe që akuzohen për vepra të ndryshme penale si vrasje, tentativa vrasjeje, trafik femrash, kultivim e shitje narkotikësh, grabitje me armë zjarri dhe mashtrim. Në këtë listë ka edhe persona të dënuar me burgim të përjetshëm. Ndërkaq, në listën në fjalë është dhe emri i Suel Çelës, 30-vjeçarit të akuzuar për tentativa vrasjeje të efektive të policisë së Elbasanit, në incidentin e rëndë të ndodhur në tregun agro-ushqimor të këtij qyteti më 18 shtator të vitit 2017. Ai është shpallur në kërkim policor, pasi gjykatat ka vendosur "Arrest me burg" ndaj tij për veprën penale "Vrasje e punonjësve të policisë mbetur në tentativa". Çela konsiderohet nga policia si një persona



me rrezikshmëri të lartë. Në foton e publikuar nga Policia e Shtetit jepet dhe emri e mbiemri tjetër i 30-vjeçarit si: Marjus (Suel) Petrit Lu-

laj (Çela). Sipas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, mjetin "Audi" që goditi policinë e ka drejtuar Suel Çela. Incidenti, nga i cili u publikuan dhe video atë kohë shkaktoi një reagim të madh në radhët e strukturave të policisë së Shtetit dhe lëvizjen duke tërhoqi vëmendjen duke u bërë lajmi kryesor në mediat shqiptare. Një tjetër personazh i njohur është edhe italiani Bruno Adolfo Pomenti, i cili në vitin 2015 u dënua me 7 vite burg me akuzën e vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit. Pomenti ishte me rezidencë në Itali, ndërsa u prangos në janar të këtij viti në një hotel të njohur në Ciocara, një qytezë në provincën e Frosinonës në Itali. Në vitin 2012 italiani mashtrroi me një çek të falsifikuar një bankë të nivelit të dytë në Elbasan, duke tërhequr shuma të konsiderueshme parash.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarimtarë gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 20.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i l-rë për shlytjen e 4 pasurive të paluajtshme, në pronësi të Shoqërisë "VIC-TORY INVEST" SH.PK me vlera fillestare në ankand: a) 252,668 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishtë me sipërfaqe totale 2,795 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 b) 244,532 (Dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishtë me sipërfaqe totale 2,705 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 c) 316,400 (Treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishtë me sipërfaqe totale 3,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 c) 135,600 (Njëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishtë me sipërfaqe totale 1,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

TENDERAT E QEVERISE DYSHIMET

Kompania që është nën hetim nga prokuroria e Tiranës fitoi tenderin e Unazës

Skandali, firma "DH Albania" fitoi tenderin 11 milionë euro nga OST "Të Paeksponuarit" zbuloi falsifikimin në SHBA

Skandali i kompanisë fantazmë Dunwell Haberman, e cila u shpall fituese në tenderin për Unazën e re, merr përmasa edhe më të rënda.

Dje u publikuan dokumentet zyrtare që tregojnë se vetëm një muaj më parë, Operatori i Sistemit të Transmetimit i ka dhënë kompanisë offshore nga Delaëare, përmes degës së saj në Tiranë "DH Albania", një tender me vlerë 11 milionë euro.

Bëhet fjalë për ndërtimin e linjës 220 kilovolt Burrel-Peshkopi dhe traktin dalës të nënstationit të Burrelit, një nga tenderat më të mëdhenj të zhvilluar nga OST gjatë këtij viti.

Sipas dokumenteve të siguruar nga Agjencia e Prokurimeve Publike, të publikuara nga Syri.net, tenderi është zhvilluar në nëntor dhe Dunwell Haberman Albania e ka fituar atë me 100 për qind të vlerës limit.


Më konkretisht, sipas dokumenteve të APP, fondi limit për ndërtimin e linjës Burrel-Peshkopi ishte përcaktuar 1 miliardë e 447 milionë lekë dhe po me këtë çmim është fituar nga DH Albania.

Ky është një sinjal shumë i fortë që ngre dyshime për tender të paracaktuar njësoj si në rastin e Unazës së Re.

Por ky nuk është dyshimi i vetëm. Dunwell Haberman Albania është krijuar në fund të qershorit të këtij viti si degë e kompanisë Dunwell Haberman të regjistruar në Delaëare të Shteteve të Bashkuara. Vetëm katër muaj më vonë, kjo kompani me administrator Avdiol Dobi, një 26 vjeçar ish receptionist në një spital privat, merr dy tendera të mëdhenj për një vlerë totale 30 milionë euro, ndërtimin e unazës së Tiranës dhe atë të linjës elektrike Burrel-Peshkopi. Skandali i Dunwell Haberman u shpërtheu kur emisioni "Të Paeksponuarit" në "News 24" publikoi dokumentet që faktonin se kompania guackë kishte falsifikuar dokumentet, përfshirë bilanci dhe firmën e Sekretarit të Shtetit në Delaëare për të fituar tenderin e Unazës së Tiranës me vlerë 18 milionë euro.

Kompania e cila pretendon se ka një eksperiencë 20 vjeçare në fushën e ndërtimit dhe energjisë, ishte krijuar vetëm në 25 qershor të këtij viti, kohë që përkon me vizitën e ministrit të energjisë Damian Gjikuari në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas publikimit të skan-



dalit qeveria u detyrua të anulonte tenderin e Unazës së Re deri në ardhjen e përgjigjeve zyrtare nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për aktivitetin e kompanisë. Por ndërsa tenderi i unazës është anuluar, pa zhurmë DH Albania ka marrë 12 milionë euro nga OST po me dokumente të falsifikuara, çka e thellon edhe më shumë skan-

dalin korruptiv të kësaj kompanie.

Dyshimet janë se pas kompanisë qëndrojnë zyrtarë të lartë të qeverisë shqiptare, të cilët krijuan një shoqëri guackë në Delaëare për të marrë 30 milionë euro para publike vetëm në dy tendera, tek Unaza e Tiranës dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë.

Reagon OST: Kompanisë "DH Albania" ia pezulluam kontratën 11 mln euro

Pas skandalit të publikuar në lidhje me kompaninë Dunwell Haberman, e cila sipas Agjencisë së Prokurimit publik thuhet se ka përfutur një tender me vlerë 11 milionë euro nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, vjen reagimi nga ky i fundit.

Përmes një njoftimi për mediat OST pohon se në momentin kur është njohur me permbajtjen e dokumenteve të shfaqura në emisionin "Të Paeksponuarit" në News 24, ku u zbulua se kompania DH Albania kishte falsifikuar firmën e sekretarit të shtetit të Delaëare, ky institucion ka marre masat për pezullimin e njëanshem të kontratës.

REAGIMI

Sqarim i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)

Referuar rastit të publikuar në median online për një kontratë që kompania DH Albania ka patur me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, OST sqaron se që në momentin kur është njohur me permbajtjen e dokumenteve të shfaqura në emisionin "Të Paeksponuarit" në News 24, ky institucion ka marre masat për pezullimin e njëanshem të kontratës.



"HAJDUT PSIKIK"



Lulzim Basha: 30 milionë euro tendera i dha Rama "kompanisë së vet"

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha reagoi dje për skandalin e kompanisë "DH Albania" e cila ka fituar tendera shumë milionëshe nga qeveria, ndërkohë që po hetohet për falsifikim në Shqipëri dhe SHBA.

"Imagjioni sa qindra miliona euro ka vjedhur ky hajdut psikik në 5 vjet si kryeministër dhe 11 vjet si kryetar bashkie. Por as paratë dhe asgjë nuk do ta shpëtojnë dot as Ramën dhe as klientët e tij nga drejtësia, për shkatërrimin që i kanë bërë Shqipërisë.

30 milionë euro tendera brenda një muaji i ka dhënë Edi Rama kompanisë Dunwell Haberman, bashkëpronar i së cilës është vetë ai me ose pa letra, për t'i grabitur dhe pastruar në SHBA", shkruajti Lulzim Basha në "Twitter".

Mashtrim me datën e krijimit, figuron e regjistruar para 6 muajsh Hetim firmës 'Dunwell Haberman' në SHBA, për falsifikim dokumentesh

Shqipëria duket se po ndeshet me një skandal të ri korupsioni, lidhur me një prej kompanive që ka fituar tenderin për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Kompania shqiptare funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware të Shteteve të Bashkuara.

Zyra e Sekretarit të Shtetit në Delaware konfirmoi për "Zërin e Ameri-

kës" se ka filluar hetimet për të përcaktuar nëse kompania Dunwell Haberman, ose ndonjë prej zyrtarëve të saj, është përfshirë në aktivitetet të paligjshme, mashtrime ose falsifikime.

Firma "Dunwell Haberman" vepron në Shqipëri përmes filialit të saj vendas "DH Albania", e cila ka fituar një tender prej rreth 20 milionë dollarësh për një prej segmenteve të unazës së madhe në Tiranë.

Firma dyshohet se ka

kryer dy falsifikime për të siguruar kontratën në Shqipëri. Ka falsifikuar datën e krijimit; në Dalaware kompania figuron e regjistruar para 6 muajsh, në 25 qershor 2018, ndërsa në Shqipëri ka depozituar dokumente, sikur ekziston që nga qershori i 1998. Dokumenti i dytë, që dyshohet të jetë falsifikuar, është një certifikatë e Sekretarit të Shtetit se kjo firmë nuk i ka detyrime fiskale shtetit. Zëdhënësi i Sekretarit të Shtetit

Buletini Nr. 40 datë 08 Tetor 2018 Agjencia e Prokurimit Publik

Numbri i referencës i procedurës: REF-81527-07-31-2018

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 06.09.2018.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Nr.31, Datë 06 Gusht 2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftimi se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë 2 (dy) ofertues, me vlerat përkatëse të ofruar si më poshtë:

- "DH Albania degë e shoqërisë së huaj Dunwell Haberman" sh.p.k. NIFT L819180088
- Me Vlerë 1.206.410.976.79 (një miliard e dyqind e gjashtë milion e katërqind e dhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pake shtatëdhjetë e nëntë) Lekë pa Tva.
- "Argus Power" sh.p.k. NIFT L410000000
- Nuk ka parqitur ofertë ekonomike.

Faksimile e Agjencisë së Prokurimit Publik

Doug Denison, i tha Zërit të Amerikës, se për certifikatën nuk ka patur asnjë kërkesë nga firma dhe as nuk është lëshuar ndonjë

dokument. Dokumentet e falsifikuara dolën për herë të parë në Shqipëri, gjatë emisionit "Të Paeksponuarit" në televizionin "News 24".

Rrëfhet regjisori: Vështirësitë në realizimin e filmit, skena që ka pasur më shumë dubla

Valmir Tertini:

Jetë e shfrenuar dhe drogë, "Vulë" rrëmben zemrat e italianëve, ja detajet

"Femra më bie ndërmend njerëzimin, botën dhe pikturën"

Egla Xhemali

Sukseset e ndjekin edhe këtë herë regjisorin Valmir Tertini. Ende pa u shfaqur filmi, ai ka marrë vlerësimin për skenarin më të mirë në Sirakuzë të Italisë. Historia e filmit vërtitet rreth Viktorias, një vajzë 28-vjeçare, që është dërguar nga shteti gjerman për në Ambasadën e Kosovës. Të gjitha aplikimet për vizën gjermane, dosjet shkojnë tek Viktoria, ndërsa ajo është e papërgjegjshme në këtë drejtim, duke i lënë anash ato dhe duke u varur nga një jetë geto. Alkool, drogë dhe mungesa e një partneri që ta përbushë. Regjisori dhe skenaristi i filmit "Vulë" na tregojnë detaje për skenat që kanë pasur më shumë dubla, se si erdhi kjo histori tek ai, kompromiset për hir të punës, si dhe vështirësitë që ka hasur për ta realizuar atë. Ai thotë se Viktoria kurrësi nuk mund t'i ngajjë dikujt tjetër. Sa i përket emrit të filmit, Tertini pohon se "Vula" vjen në formën e një metafore, pasi ajo nuk shihet në asnjë pjesë të filmit. Në vetvete vula përfaqëson një cikël që është mbyllur. Pas vlerësimit në Itali, regjisori thotë se ka dëshirë që të dëgjojë edhe reagimin e ambasadeve. Kur një punë do ta finalizosh sa më mirë dhe të marrësh 'feedback'-un e merituar, natyrisht që duhet kohë. Valmiri është duke u marrë me një skenar tjetër, ndërkohë që pranon se ka goxha vështirësi në realizimin e një filmi. Ne i urojmë suksese dhe punë sa më të frytshme në vazhdim!

Si erdhi filmi "Vulë"? Na tregoni disa detaje.

Nisi si ide që e kisha dëgjuar, s'e mendova që do e vazhdoja në skenar, me kohë binda veten se është një rrëfim unik, i paimagjinuar, por real nëse kalojmë në këtë harkë zinxhior, bindemi. Ne i besojmë të huajve, por dhe ata dinë të jenë të pandërgjegjshëm. Nuk desha të rrëfej institucionin, por vetëm personazhin, jetën




geto të Viktorias në Prishtinë.

Personazhi kryesor Viktoria bën një jetë të shfrenuar deri diku. Sa u ngjason ajo femrave shqiptare?

Ajo është Viktoria, ajo nuk i ngjason as komunitetit prej nga vjen. Ajo e njej veten mbas veprimeve që bën, jo më t'i ngjasojë dikujt tjetër. **Pse zgjodhët titullin "Vulë" për filmin? Ka ndonjë**

domethënie apo rastësi?

E vetmja punë që ka Viktoria është të vërë vulën, madje s'e bën as këtë gjë, por grumbullon dosjet. Vula nuk shihet në film, mund të them është një metaforë, ose kapa-



ku i mbaruar i një cikli.

Skena që ka pasur më shumë dubla?

Dy skenat erotike që ka filmi.

Momenti më i bukur gjatë xhirimeve?

Kur një mace hipi në karriren time.

Ju keni fituar një çmim në Itali ende pa u shfaqur filmi. Cila është pritshmëria juaj më e madhe?

Pas premierës në disa vende që kemi synim, do vazhdojë edhe në festivale. Dua ta shfaq dhe në ambasada shqiptare. Megjithatë është i ambasadeve, dua reagimet e tyre.

Kompromisi më i vështirë që keni bërë për hir të punës?

Kam shumë durim kur dua të arrij diçka. Mbasi të mbaroj, nuk dua të duroj më. Kompromisi është vizioni dhe qëllimi.

Pas "Vulës"?


"Vula" është në fazën e 3-të dhe në fillimvit do të dalë. Po shkruaj një skenar të gjatë. Nuk kam qejf t'i nxitij gjërat. Diçka që nisat do bëhet, madje në mënyrën më të mirë të mundur, çdo gjë ka kohën e vet.

Sa e vështirë është të bësh një film?

Shumë e vështirë për t'u quajtur film, të xhirosh e të montosh mund ta bëjë çdokush. Trajtimi, qasja, këndvështrimi, narratologjia, zhvillimi i karaktereve, këto janë problematikat në kinematografinë shqiptare.

Kur përmendet femra, çfarë të bie ndërmend?

Njerëzimi, bota, piktura...



Flori Mumajesi "vdes" për këtë gjë të Fifit, ja çfarë i dedikon këngëtarja

A ta janë dy nga zërat më të bukur të muzikës shqiptare. Ishin konkurrentë në "Kënga Magjike", por Fifi dhe Flori Mumajesi janë dy miq shumë të mirë profesionistë dhe këtë e kemi parë në çdo postim në rrjetet sociale. Para disa ditësh qarkulloi një video ku shfaqen ata duke performuar një këngë të Florit dhe dukeshin shumë të afert, ndërkohë që ditën e djeshme, Fifi u shpreh se Flori e ka merituar gminin e parë në "Kënga Magjike". Flori ka publikuar ditën e sotme një video të Fifit duke qeshur dhe të qeshurën e saj e cilëson si "Zemër" ose dashuri, merreni si të doni. Kjo gjë i ka pëlqyer Fifit dhe e ka publikuar në "Instastory", ku u shpreh: "E qeshur e personalizume, në këtë rast me ose pa kontratë vetëm për ty".



Almeda i preku të gjithë me fjalët e ëmbla, zbuloni si ia kthen aktori turk

A ta janë një ndër çiftet më simpatike dhe të dashur si për publikun shqiptar, ashtu edhe për atë turk. Almeda Abazi dhe bashkëshorti i saj, Tolgahan Sayisman festuan dje përvjetorin e katërt të dashurisë së tyre. Ishte prezantuesja shqiptare, ajo që përmes një postimi në "Instagram" kujtoi datën e rëndësishme me foton ku duken të përqafuar duke shkruar: "Gëzuar përvjetorin e katërt dashuria ime...". Nëse Almeda ia shkroi në gjuhën angleze, Tolga na habiti të gjithëve pasi ia ktheu në gjuhën e bukur shqipe: "Të dua shumë" dhe i vendosi një zemër emoji.



"Iku për lesh", Mozzik shpërthen ndaj muzikës shqiptare

Mozzik është një ndër reperët më të pëlqyer për publikun shqiptar. Me projektet e tij të shumta ka ditur si të fitojë zemrat e të gjithëve. Edhe pse këngët e tij janë prituri mirë nga publiku, duke marrë miliona klikime siç ishte rasti i bashkëpunimi të tij me të dashurën Loredana, reperi nuk është i kënaqur nga ky treg muzikor. Në një postim së fundmi në "Instastory", ai ka deklaruar se tregu muzikor nuk po funksionon si duhet. "Iky për lesh kjo muzikë dhe ky treg", shkruan në postim Mozzik. Nuk e dimë nëse ky është ndonjë 'diss' apo është thjesht pakënaqësi ndaj mënyrës sesi funksionon tregu muzikor shqiptar.



Zhvishet Keisi Meidini, vajza e Sabianit e "dogji" përsëri rrjetin me foto provokuese

Vajza e këngëtarit të njohur ka "ndezur" sërish rrjetin me foto provokuese. Bukuroshja ka zbërthyer pantallonat teksa pozon me një badi me ngjyrë të zeze. Ajo gjithmonë ka qenë tejet provokuese. Modelja nuk mund të dukej më seksi se kaq. Biondia është komentuar shumë për imazhet e postuara së fundmi dhe jo vetëm. Ndjekësit e saj e kanë komplimentuar edhe këtë herë, duke treguar se janë aty për ta mbështetur në gjithçka që Keisi do ndërmarrë. Veç postimeve dhe seteve fotografike që nxjerrin në pah anën më të nxehtë të saj, nga bukuroshja nuk kemi parë ende projektet muzikore, që u tha se do t'i publikonte shumë shpejt.



LETËRSI

RIDVAN DIBRA

Shkrimtari, kandidat për çmimin letrar "Balkanika 2017"

Shkrimtari shqiptar, Ridvan Dibra, autor i mbi njëzet li brave në prozë, poezi, eseistike e studime letrare, si një prej zërave më të rëndësishëm e novator të letërsisë shqipe pas viteve '90, do të përfaqësojë këtë vit letërsinë shqipe në një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore dhe letrare për rajonin e Ballkanit, që mban emrin simbolik "Balkanika", me romanin e tij "Legjenda e vetmisë" (botuar në shqip nga "Onufri", 2012).

Këtë vit, kjo ngjarje e rëndësishme kulturore do të organizohet në Bukuresht të Rumanisë, më 15 dhjetor 2018, ndërkohë që juria ndërkombëtare do të mbledhet për të diskutuar dhe vendosur për veprën më të mirë të botuar në rajonin e Ballkanit, në datat 13-15 dhjetor. Përfaqësuese e Shqipërisë në jurinë ndërkombëtare është Bisej Kapo.

Botimet "Toena" si pjesë e Fondacionit "Balkanika" (me qendër në Sofje) organizojnë mbledhjen dhe funksionimin e jurisë kombëtare që vendos çdo vit për përfaqësimin e Shqipërisë në këtë kompeticion letrar ballkanik.

Anëtarët e jurisë kombëtare të këtij edicioni ishin: prof. Floresha Dado, Piro Misha, Diana Çuli, Sonila Kapo, Preç Zogaj.

"Balkanika" është çmimi letrar më i rëndësishëm që ndahet për letërsinë ballkanike.

Krijimtaria e Ridvan Dibrës, që përfaqëson letërsinë shqipe në këtë konkurs, është përkthyer në disa gjuhë, si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, rumanisht, malajzise, boshnjake etj., si dhe përfshirë në disa antologji brenda e jashtë vendit.

Ridvan Dibra është fitues i disa çmimeve kombëtare e mbarëkombëtare. Me romanin "Legjenda e vetmisë", ai fitoi çmimin "Rexhai Surroi" (2012), si romani më i mirë i botuar në hapësirën mbarëshqiptare. Në vitin 2018 ky roman u përkthye në frëngjisht me titullin "Le Petit Bala. La Légende de la solitude", me përkthimin e Evelyn Noygues me botues "Le Ver à Soie".

Romani "Legjenda e vetmisë" mbështetet mbi një këngë të vjetër shqiptare, ku spikasin dy vargjet



Ridvan Dibra



që shënojnë edhe hyrjen e romanit: "Nana djalit ka qorrue me gjaks t'burrit me u martue". Mbi

Romani me karakter psikologjik "Legjenda e vetmisë" konkurron në Bukuresht

një bazë të tillë autori ndërton një roman të karakterit psikologjik, një roman mbi vetminë dhe hakmarrjen, duke vënë në qendër personazhin e Balës, i cili vuan vrasjen e misterhme të babait të tij. Përmes një stili mjaft elegant, plot poezi, ritëm e ndjeshmëri, lexuesi ndjek me interes gjithë ankthet e dyshimet e Balës rreth vrasjes së të atit (e fshehur si vetëvrasje) dhe rrekjet e tij të pasuksesshme për t'u hakmarrë. I veçuar i vetmuar e i keqkuptuar, Bala nis e merr atributet e një Edipi a Hamleti modern, duke sjellë risi në personazhet e romanit shqiptar.

E këtë roman proza dhe poezia, ritmi dhe aritmia, thellësia dhe të vështruarit nga jashtë synojnë të

sjellin një realitet.

Urojmë që shkrimtari Ridvan Dibra të marrë këtë çmim të rëndësishëm letrar ballkanik dhe të përjetojmë të njëjtat emocione si në vitin 2002 kur fitues u shpall shkrimtari Fatos Kongoli, në vitin 2009 kur fitues u shpall Ismail Kadare apo në vitin 2015 kur fitues u shpall Bashkim Shehu!


KANDIDATËT

ETJERË

Shkrimtarët pjesëmarrës të këtij edicioni, në garë për çmimin "Balkanika", sipas vendeve përkatëse, janë:

- Ridvan Dibra "Le petit Bala: La Légende de la solitude" (Legjenda e vetmisë) - Shqipëria.

- Aksinia Mihaylova "Change-



ment des miroires" (Ndryshimi i pasqyrave) - Bullgaria.

- Ermis Lafazanovski "Histoires" (Tregime) - Shkupi.

- Rhea Galanaki "L'ultime humiliation" (Poshtërimi i fundit) - Greqia.

- Ayhan Geçgin "La longue marche" (Rrugëtimiti gjatë) - Turqia.

- Eugen Uricaru "Le poids d'un ange" (Pesha e një engjëlli) - Rumania.

- Sr?an Srdi? "Combustion" (Djegje) - Serbia.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



LIBRI

Gazmend Kapllani: "I keqi i vetes", një Uliks pa Itakë

Fatmira Nikolli

Ingjan një Uliks pa Itakë. Karli, njëri nga dy vëllezërit e romanit më të ri të Gazmend Kapllanit "I keqi i vetes". Ai kthehet në atdhe për të përcjellë në banesën e fundit babanë e tij, një ish-komunist që vitet e fundit të jetës është bërë mysliman i devotshëm. Nëna ka kohë që ikur, në një mënyrë të befte, duke e vendosur vetë kur ikën, duke zgjedhur të ikë e t'u kthejë shpinën të gjithëve.

Kur Karli kthehet në Ters, pak gjë ka ndryshuar. Qyteti është i trishtë, i humbur, i zhytur në mallkimin e vet dhe në fatin e vet. Mes rrëfimeve të njërit vëlla, dhe monologëve të tjetrit, si altergo të njeri-tjetrit gjen dy Shqipëri, dy botë, dy ëndrra. Ndesh dyzimin mes ikjes dhe asaj që merr me vete, asaj që humb e asaj që lë pas-mundësive të pafundme të ardhmërive të pajetuara. Gjen Uliksin pa Itakë tashmë, të mbetur si tek Kundera mes botësh.

Promovimi

Libri i promovua dje në Tirana Times. Botuesja Rita Petro tha se kur e mora në duar dorëshkrimin, pas disa vitesh në Greqi në kursin e filozofisë, e përjetova si lexuese. "Një libër i bukur të lë mbresa për 48 orë. Kur e përjeton tranzicionin përmes një libri është dyfish mbresëlënëse.

Është një lloj xhelozie e bukur kur gjen në një libër ato që ke menduar vetë, por jo aq bukur. Mënyrat e rrefimit, për dy vëllezër që i përjetojnë ndryshe të njëjtat situata. Ditari është përkthyer në 10 gjuhë. Është fitues i çmimit "Letra nga fronti". Më quajnë Europa dhe faja e fundit janë shkruar në Greqisht dhe botuar në frëngjisht", tha Petro. Ajo vuri në dukje se ka qenë pedagog në Greqi dhe tani në Boston.

"Titulli është alegorik. Njeriu është i keqi i vetes apo mendojnë kështu për të. Ai është i miri i vetes se ka zgjedhur mes mënyrës së re të jetesës dhe nostalgjisë", -tha Petro.

Vetë Gazmend Kapllani tha se libri nuk ekziston pa botuesen, unë nuk ekzistoj pa lexuesin. Kujto se me Visar Zhitin janë takuar në Lushnjë kur lexonin poezitë fshehurazi. Pinin cigare 'Partizani' dhe flisnin për letërsi.

"Kam studiuar për Bio-Kimi se kështu donte partia. Meqë isha i persektuar më dhanë këtë. Nuk mësova asgjë përveç procesit të mejozës e metizës dhe copëzimi i sepjes. Ndaj përktheja poezi të ndaluar nga Zhak Prevert", -tha Kapllani.

Zgjedhi të lexojë një pjesë nga libri. "Po zgjedh Frederikun se Karlin e ndjej më afër. Është larg meje, është një filozofi me të cilën jam në konflikt. Nuk doja të dilte karikaturë e vetes. Doja që konflikti mes tyre të ishte i drejtë dhe i vërtetë. Nëse do të kuptojë karak-



Autori prezanton romanin, dy vëllezërit e letërsisë moderne

teret duhet ti njohë e trajtojë njësoj. Ndryshe është më mirë të trajtojë pamflete", tha Kapllani. Gazmendi Kapllani shtoi se nuk e ka braktisur shqipen.

Mirela Kumbaro në fjalën e saj jashtë pozicionit tha se e ka zbuluar para se të isha ministre. "E falënderoj që shkroi shqip. E kam lexuar në frëngjisht. Dhe jam befasuar. Në librin e parë gjeta autorin dhe doja ta lexoja në shqip. E kam blerë për ta dhuruar. Dhe për kolegët ministra e politikanë. Është libër që tregon se po lind letërsia e emigracionit. E shkruar jashtë e që duket sikur është shkruar këtu.



"Letërsia e lidhur me historinë. Është tragjedi e madhe ajo që ka nodh me ne. Asnjë nuk e përjetoj atë që përjetuam ne. Kur ndodhi ringjallja e madhe e letërsisë", tha ai. Kujtoi se një ditë kur intervistoi Ramiz Alinë e pyeti "pse i ndaluan librat, këtë kam dashur të di të gjithnjë. Pse e kanë frikë diktaturat letërsinë e jo biologjinë e matematikën? Ai thoshte në kohën tjetër. Më pa me një pamje përdelley-

ese. Është si prindi që do të mbrojë fëmijët-tha Alia. Për Kapllanin ata (komunistët) kanë qenë mjeranë. Të mjerë shpirtërisht, superprovincialë. "Shkatërruan kulturën e këtij kombi. Se kuptoj si ka jetuar që vazhdon e mbijeton. Unë s'njihja Visarin. Ka qenë e varrosur dhe po mundohet të bëhet person.

Emigranti urë lidhëse, por ka humbur edhe atdheun. Ka një tension mes asaj që do të thotë shkrimtari e asaj që shkrimtari mendon se do dojë lexuesin, shtoi shkrimtari.

Zhiti e cilësoi një libër të shkëlqyer. "Dy virtutet e tij janë përgjegjshmëria si shkrimtar, ndërgjegjja e krijesit dhe e dyta kam zbuluar që ka adhurim për lexuesin. Kapllani do lexuesin real për të takuar lexuesin e tij që ka kaluar oqeanin. Për librat e bukur nuk flet dot. Libri i bukur vetëm lexohet. E kam lexuar pa u botuar. Rashë në grackën e rilëximit se sa herë e lexon gjen gjëra të reja. Përzhjehen tragjedia shqiptare e ballkanike. Arrin lartësinë që priste letërsia shqipe e postdiktaturës", -tha Zhiti.

Për të libri ka muzikë zëulët të trishtë si melodi. Ai tha se është roman i ngjeshur me ngjarje e kohë me personazhe të thukët. "Është romani i dhembjes njerëzore. Ngjarja është vendosur në

qytetin e trilluar, Ters. Herë më duket si Lushnjë, pastaj si nga Shkodra, Korça e Tirana. Ka personazhe kokëshkretë. Familje normale, Babai komunist që bëhet mysliman. Djali i madh i lidhur me nënën që do të vrasë veten. Dy vëllezër alterego. Jo Abeli e Kaini jo vëllezër biblikë, por që e vrasin njëri-tjetrin përditë. Zhiti tha se mbase grekërit duke u sjellë keq me shqiptarët ndëshkonin të ikurit. "Masakra mbi çamët është rrëfyer në mënyrë të përkryer në libër. Një lopë që digjet. Gjatë masakrës shpërthen si një fishekzjarre. Kompleksi i Edipit, e kthen vdekja në atdhe e një varrim pa funeral. Lot të panjohur të atij që s'qan dot për të atin por shkrehet në lot një vajzë që s'e ka parë kurrë. Është elegji e bukur shqiptare. Jemi ne që i bëjmë keq vetes. Gjuhë e kultivuar e elegante. Janë të përziera përvojat e poetit e gazetarit. Mendimet arrijnë deri në filozofi", tha Visar Zhiti, një nga lexuesit e parë.

Kujto se kur u lirua nga Lushnja e punoi në fabrikë të tullave, kishte menduar t'i fliste atyre që flisnin. "S'para të fliste ndokush. Gazmendi m'u afrua e më dha shumë. Më njohu me Bodlerin që kishte përkthyer. Dëgjonte lajmet frëngjisht. Kur nisën lëvizjet për ndryshim në Shqipëri e në Lushnjë po aktivizoheshim dhe ne. E ngritën Gazmendin dhe i dhanë një megafon. Policia e kërkonte. Gazi filloi një jetë ilegale. Një polic vinte të kërkonte një të arratisur. Kishte në inventar pranget. Gazi iku në Greqi. Atje bëri punë të rënda. Studiu për filozofi dhe punoi si gazetar.

U fut aventurave për të liruar të burgosur. E kërcënuam me vdekje dhe iku në Boston prej 5 vitesh. Atje jep letërsi", -tha Zhiti.

Mirela Kumbaro në fjalën e saj jashtë pozicionit tha se e ka zbuluar para se të isha ministre. "E falënderoj që shkroi shqip. E kam lexuar në frëngjisht. Dhe jam befasuar. Në librin e parë gjeta autorin dhe doja ta lexoja në shqip. E kam blerë për ta dhuruar. Dhe për kolegët ministra e politikanë. Është libër që tregon se po lind letërsia e emigracionit. E shkruar jashtë e që duket sikur është shkruar këtu. Lëxoj atë që di, kërkoi atë që dua dhe zbuloi atë që gjë. Lexova një letërsi prej Kundera, ma sollin fort atë si Uliksi. Është letërsi emigracioni që karakteristike e letërsisë së emergjencës. Mënyra se si ne kemi jetuar jetë paralele përmes letërsisë një botë që njihim. Më pas zbulova shkrimtarin Kapllanin. Sa shqiptare dhe universale", -tha Kumbaro.

Vuçiç: Kosova po përgatit masa të reja ndaj Serbisë

Taksa 100%, këshilltari i kryeministrit: S'do tolerojmë të na trajtojnë si më parë

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç deklaroi dje se ka informacione që Kosova po përgatit edhe 3 masa të reja ndaj Serbisë. Vuçiç ka thënë se nuk e dinë saktë se për çfarë bëhet fjalë mirëpo shteti serb kësaj here do të kundërpërgjigjet. Këshilltari i kryeministrit Haradinaj, Avni Arifi e ka thënë se do merren masa të reja pa i specifikuar ato. Arifi ka theksuar se këto masa janë pjesë e një strategjie.

AVNI ARIFI

"Nuk mund t'i specifikoj këto masa, por mund të them se janë pjesë e një strategjie. Ne nuk do të tolerojmë më tutje që Kosova të trajtohet nga shteti i Serbisë në formën si është trajtuar vitet e kaluara", - ka deklaruar këshilltari i kryeministrit.

"Nuk mund t'i specifikoj këto masa, por mund të them se janë pjesë e një strategjie. Ne nuk do të tolerojmë më tutje që Kosova të trajtohet nga shteti i Serbisë në formën si është trajtuar vitet e kaluara", -ka deklaruar këshilltari i kryeministrit. Sipas Arifit, tash e tutje Kosova do ta mbrojë



Aleksander Vuçiç

veten dhe nuk do të lejojë që politikat të jenë vetëm të njëanshme. Theksojmë se të cilat importohen nga qeveria e Kosovës më 21 nëntor ka vendosur taksa 100 për qind ndaj mallrave, të cilat importohen nga Serbia.

"Është e rëndësishme të respektohen parimet e së drejtës ndërkombëtare"

Mogherini: Marrëveshja Kosovë-Serbi, jo ndarje në vija etnike

Shefja e politikës së jashtme të BE: Të hiqet taksa 100%

Diçkë e hënë, shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka thënë se çfarëdo marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve që mund të arrijnë Kosovë dhe Serbia, përfshirë edhe korrigjimin e mundshëm të kufijve, nuk guxon të mbështetet në linja etnike. Ajo i bëri këto komente pas takimit të shefave të diplomacive të vendeve të Bashkimit Evropian, të cilët përveç të tjerash diskutuan edhe për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor përfshirë edhe bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat aktualisht kanë ngecur. Zonja Mogherini tha se bisedimet janë në "vështirësi", duke vënë theksin tek tarifat prej 100 për qind që qeveria e Kosovës u ka vënë mallrave nga Serbia dhe Bosnja, një veprim që nxiti reagimin e Beogradit i cili kushtëzoi vazhdimin e bisedimeve me heqjen e tarifave. Ajo sërish i bëri thirrje Prishtinës që të heqë tarifat, ndërsa shfaqti besimin se ende është e mundur të arrihet një marrëveshje "ligjore gjithëpërfshirëse" për normalizimin e marrëdhënieve. Marrëveshja, tha ajo, do të duhet të përfshinte të gjitha çështjet e hapura. Zonja Mogherini tha se për Bashkimin Evropian është me rëndësi që ajo marrëveshje të respektojë të parimet e së drejtës ndërkombëtare. "Më lejoni të them qartazi. Jo ndarje në vija etnike. Që të jem edhe më e qartë, çfarëdo 'korrigjimesh' që të dyja palët mund të diskutojnë në të ardhmen, marrëveshja nuk duhet të përfundojë me krijimin e shteteve etnikisht të pastra. Në çdo rast, të dyja vendet duhet të jenë shumetnike", -tha ajo, duke nënvizuar se u takon palëve që të përcaktojnë se çfarë do të jetë zgjidhja përfundimtare. Gjatë verës presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi



Shefja e politikës së jashtme të BE, Federica Mogherini

FEDERICA MOGHERINI

"Më lejoni të them qartazi. Jo ndarje në vija etnike. Që të jem edhe më e qartë, çfarëdo 'korrigjimesh' që të dyja palët mund të diskutojnë në të ardhmen, marrëveshja nuk duhet të përfundojë me krijimin e shteteve etnikisht të pastra. Në çdo rast, të dyja vendet duhet të jenë shumetnike", - tha Mogherini.

dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, kërkuan mbështetje ndërkombëtare për një marrëveshje që do të mund të prekte edhe kufijtë ndërmjet të dyja vendeve. Presidenti Thaçi, hodhi idenë e "korrigjimit të kufirit" që sipas tij, nënkuptonte bashkimin e Luginës së Preshevës, një rajon me shumicë shqiptare në jug të Serbisë me Kosovën. Presidenti Vuçiç, hodhi idenë e 'vënies së kufirit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve', që nënkupton ndarjen e Kosovës asisoj që veriu i saj më shumicë serbe t'i takojë Serbisë. Idetë e tyre

nxitën reagime në Kosovë dhe Serbi, por edhe skenën ndërkombëtare, ndërmjet atyre që do të mbështesnin mundësinë e prekjes së kufijve nëse palët pajtohen dhe atyre që pohojnë se kjo do të shkaktojë reagime zinxhirorë në Ballkan. Presidenti serb tha kohëve të fundit se ideja e tij ka rënë poshtë meqë "opinionet serb nuk e mbështeti atë". Presidenti Thaçi në një intervistë për Zërin e Amerikës në fund të nëntorit tha se arritja e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë, që do të çonte në një njohje të ndërsjellë të të dy shteteve

si vende sovraane, nuk mund të arrihet pa definimin e kufirit me Serbinë. Serbia vazhdon të kundërshtojë pavarësinë e Kosovës por është përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve që është kusht për integrimin e të dyja palëve në Bashkimin Evropian. Por, Kosova vazhdon të jetë e fundit në proceset integruese dhe vendi i vetëm në rajon që nuk është përfshirë në regjimin e udhëtimit pa viza, shkruan Zëri i Amerikës. Serbia ndërkaq hapi të hënën edhe dy nga 35 kapitujt e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, të cilat iu hapën asaj si kundërshpërblim për angazhimin në bisedimet me Kosovën, e cila ndërkaq ka një marrëveshje për stabilizim-asociim me Bashkimin Evropian.



Eurokomisioneri Johannes Hahn

Eurokomisioneri Hahn: S'besoj se Hungaria do ekstradojë Gruevskin

Komisioneri i zgjerimit të BE-së Johannes Hahn tha ditën e djeshme para Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme se nuk beson se Nikolla Gruevski do të ekstradohet nga Hungaria në Maqedoni, njofton "Zurnal". I pyetur nëse ai mbështet ndryshimet e raportit të Parlamentit Evropian për Maqedoninë, të cilat kërkojnë Hungaria ta kthen Gruevskin në Maqedoni, Han u përgjigj: "Unë shpresoj se kjo do të ndodhë, por jo shumë e mundshme për shkak se të dy vendet nuk kanë një marrëveshje, por unë e kuptoj pozitën e Parlamentit Evropian", - ka thënë eurokomisioneri Johannes Hahn.

JOHANNES HAHN

"Unë shpresoj që kjo të ndodhë, por nuk është shumë e mundshme për shkak se të dyja vendet nuk kanë një marrëveshje, por unë e kuptoj pozitën e Parlamentit Evropian", - ka thënë eurokomisioneri Johannes Hahn.

Tenton të ndalë dhunën, Macron plotëson kërkesat e 'jelekëverdheve'

4 fundjave protesta, ministri francez: Katastrofë për ekonominë e vendit dhe tregtinë



lueshme koston e jetesës me reformat ekonomike. Javën e kaluar qeveria franceze u tërhoq nga rrit-

ja e tatimit për karburantin, por 'jelekëverdhet' nuk i ndalën protestat e dhunshme. Dëmi ekonomik, sipas ministrit të Brendshëm Bruno Le Mer, është katastrofik dhe do të ketë ndikim negativ afatgjatë në buxhet dhe turizëm. Nga ana tjetër protestat e "jelekëverdheve" janë "katastrofë" për ekonominë franceze. Këtë e ka thënë ministri i Financave së Francës Bruno Le Maire. Ai e quajti situatën si "krizë" edhe për shoqërinë, por edhe për demokracinë. "Është një

BRUNO LE MAIRE
"Protestat e 'jelekëverdheve' janë katastrofë për ekonominë franceze. Situata është në krizë edhe për shoqërinë, por edhe për demokracinë. Është një katastrofë për tregtinë, një katastrofë për ekonominë tonë", - tha ministri i Financave, Le Marie.

katastrofë për tregtinë, një katastrofë për ekonominë tonë", tha ai, teksa po vizitonte dyqanet e dëmtuara gjatë protestave në Paris. Për katër javë rresht, Franca është përballur me protesta kundër rritjes së çmimit të karburanteve, rritjen e çmimit të jetesës dhe çështje të tjera. Disa vende turistike, përfshirë Kullën Eiffel dhe Muzeu i Luvrit u mbyllën për shkak të protestave gjatë kësaj fundjave. Rreth 125 mijë persona protestuan të shpërndarë në Francë dhe mbi 1700 persona u arrestuan.

Pas 4 fundjavave protesta në gjithë vendin të 'jelekëverdheve', presidenti francez Emmanuel Macron bëri përpjekjen personale për t'i bindur të ndalin dhunën. Shefi i Elysee doli në një konferencë për shtyp mbrëmjen e djeshme për të njoftuar, siç shkruajnë mediat franceze, lëshimet që do t'u bëhen protestuesve. Macron shprehu rritjen e kufirit të pagës minimale, përshpejtimin e procedurave për heqjen e taksës për banesën si dhe rishikimin e moshës së daljes në pension. Këto janë edhe disa prej kërkesave bazë të protestuesve, të cilët akuzojnë qeverinë se ua ka bërë të papërbal-

Gjykata Europiane e Drejtësisë: Anulim i njëanshëm i daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE

May përgënjeshtrohet zërat për shtyrje të votimit për Brexit

'Sunday Times': Ministrat po thurin plane për referendum të dytë



Kryeministria britanike, Theresa May

të cilën May ka negociuar në Bruksel. Alternativat do të ishin një dalje e çrregullt nga BE ose ndoshta edhe fare jo Brexit. Sipas 'Sunday Times', disa ministra po thurin plane për një referendum të dytë. Ministria e Punës, Amber Rudd është shprehur tashmë për modelin Norvegji-Plus ose për një referendum të dytë si alternativat për planet e tanishme të Brexitit. Nëse marrëveshja për daljen nga BE për të cilën është rënë dakord nuk miratohet, modeli Norvegji-Plus mund të ishte plani B, i tha Rudd stacionit BBC dhe gazetës "The Times". Asnjë ministër tjetër nuk është shprehur më parë kaq publikisht për këtë model. Në rastin e modelit Norvegji-Plus, Britania e Madhe do të qëndronte

në tregun e brendshëm dhe në bashkimin doganor. Ky model mund të marrë një shumicë të kufijve të grupeve parlamentare në parlamentin britanik. Norvegjia është anëtare e Hapësirës Ekonomike Evropiane, por jo anëtare e BE. Britania e Madhe mund të binte dakord për një bashkim doganor shtesë me Brukselin - pra Norvegji Plus. Por një dalje nga BE pa marrëveshje, mund të shkaktohte një kaos në Britaninë e Madhe, i tha ministria BBC. Prandaj duhet vlerë mendja për alternativa. Këtu bën pjesë edhe një referendum i dytë. Ajo vetë do të votonte në një rast të tillë për të qëndruar në BE. Vetëm 36 orë para votimit të së martës, gjykata tha se Londra mund të tërheqë njëanshëm dhe pa

dënime artikullin e 50 për largimin nga BE-ja. "Mbretëria e Bashkuar është e lirë të anulohet në mënyrë të njëanshme njoftimin për qëllimin e saj për t'u tërhequr nga BE-ja", thuhet në vendimin e gjykatës. "Një anulim i tillë, i vendosur në përputhje me kërkesat e kushtetuese, kombëtare, do të kishte efektin që Mbretëria e Bashkuar të mbetet në BE nën kushte të pandryshuara", sh-

kruan 'VOA'. E ardhmja e BREXIT-it mbetet thellësisht e pasigurt pasi dhjetëra ligjvënës janë zotuar publikisht të votojnë kundër marrëveshjes së kryeministres May. Në referendumin e 23 qershorit të vitit 2016, 17.4 milionë votues apo 52 për qind, mbështetën BREXIT-in, ndërsa 16.1 milionë apo 48 për qind votuan për të mbetur pjesë e bllokut.

SHKURT

Ndërron jetë foshnja 2-mujajshe nga mjekimi i gabuar

Nga pakujdesia e mjekëve një vogëlushe 2 muajshe ka ndërruar jetë nga meningjiti. Mjekët e spitalit të femijëve në Edinburg thanë se vogëlushja Amber Rafferty vuante nga kapsllëku dhe e mbajtën vetëm disa orë në spital, ndërkohë që kishin gabuar, pasi ajo kishte meningjit në fazë të hershme. Pas disa kontrolleve dhe një mjekimi, prindërit e saj Veronica Rafferty dhe Scott Rafferty u konsultuan me mjekun dhe ai i rekomandoi që nuk ishte më e nevojshme që vogëlushja të qëndronte në spital. Por ajo ndërroi jetë disa orë më vonë, raporton "Metro". Prindërit e Amber akuzuan spitalin për neglizhencë pasi ajo nuk është trajtuar siç duhet nga mjekët. Sipas prindërve vajza ka pasur meningjit në fazën e hershme dhe duhej trajtuar, por mjekët e kanë nxjerrë menjëherë nga spitali. Edhe pse ata e cuan Amber menjëherë në spital dhe mjekët tentuan ta kthenin në jetë ishte e pamundur, pasi zemra e saj kishte pushuar përgjithmonë.

Zjarr i madh në një pallat në Itali, humbin jetën 2 persona

2 të vdekur dhe 40 të lënduar është bilanci i një zjarri të madh që përfshiu një pallat banimi në Rexho Emilia në veri të Italisë ditën e djeshme. Mes të plagosurve janë 2 vajza të mitura që ndodhen në gjendje të rëndë në spital. Disa prej të plagosurve kanë marrë dëgjje në trup, por shumica e tyre po vuajnë pasojat e asfiksionit. Zjarri ra rreth mesnatës në një pallat 4 katësh, ndërsa shkaqet janë ende të paqarta.

SHBA-të, lidere në tregtimin e armëve

Për tregtarët e armëve vitit 2017 ka qenë padyshim një vit i begatë. Vlera totale e armëve të shitura vetëm vitin e kaluar arriti në 398 miliardë dollarë. Industria globale e armëve pati rritje me 2.5% krahasuar me vitin pararendës. Kompanitë amerikane patën dominimin absolut të tregut të armatimit për të tretin vit radhazi. Kryesiminin e listës me 100 prodhues nga e gjithë bota e kanë firmat amerikane Lohid Martin e Boeing. Së bashku me prodhuesit e tjerë nga ky vend, ata zënë 57% të tregut me 226.6 miliardë dollarë shitje. Surprizë është zhvillimi i madh i industrisë ruse të armatimeve, që për të parën herë në 2017-ën i rëmbeu Britanisë së Madhe vendin e dytë, në listën e institutit suedez SIPRI. Firmat ruse patën rritje të fortë me 8.5% me të ardhura vjetore prej 37.7 miliardë Dollarë. Britania e Madhe dominon mes firmave europiane.

NUK ËSHTË AKSIDENT, ËSHTË REVOLTË!



FOTOLAJM

Pas Francës, protesta gjatë fundjavës ka pasur edhe në Belgjikë e Holandë. Një mënyrë origjinale për të protestuar rritjen e çmimit të karburanteve ka gjetur edhe një fermer në provincën e Sakrayas në Turqi. Sipas agjencisë së lajmeve "IHA", Ibrahim Kurt është shtrirë nën gomën e traktorit të tij për të treguar se fermerët po shtypen nga çmimi i lartë i karburanteve.

Opinion i Ditës

Studentët, OP, demokracia

Nga Edvin Parruca

(vijon nga faqja 1)

...e megjithatë është politike
1. Studentët
... e zërit, kori më i fortë tregoi që ishte shumica, pjesa tjetër u bind edhe në 8 dhjetor dolën të gjithë bashkë.

Pardje u shtynë e u shanë dhe mos u çudisi hiç që në ngjarje të tilla ndodh edhe kështu, pastaj u ndanë në dy grupe ngjitur njëri-tjetrit dhe qëndruan aty, një turmë e vetme, deri në fund të ditës dhe do dalin prapë nesër (sot).

Ajo turmë ka fituar tashmë një jetë të sajën, me një mekanizëm vetëmbrojtjeje ata vendosën të mos nxjerrin përfaqësi, të mos bëjnë negociata, të qëndrojnë vetëm te kërkesat fillestare, të bërtasin 'jo politike' dhe të përzënë cilindo që u duket i ndryshëm, sepse e ndëjnë që po avancuan edhe fare pak më tej do të ndahen. Është një proces gati gjatë.

Ata po bëjnë të pamundurën që të rrinë bashkë, pavarësisht se secili aty ka axhendën e tij. Po normale është që secili ka axhendën e tij. (Pse, unë që dola t'i mbështes, mos dola gjë për uljen e tarifës së provimeve të mbartura? Unë dola ngaqë kujtova se nisi revolucionin)

Çdokush që është student ka të drejtë të jetë atje, edhe ata të forumeve partiake, ndoshta frymëzohen dhe verës tjetër nuk shkojnë më në kampin e Jalit. Shpirti i asaj turme po i mban të gjithë aty brenda.

Deri tani po ia dalin të rrinë bashkë, nëse nuk ia dalin më vonë s'ka vend për dëshpërim, kështu e kanë këto punë. Ndërkohë le të shijojmë mrekullinë.

2. OP
Vijmë të patatja e nxehtë tani dhe këtu diskutimi është pak më i komplikuar.

Por, së pari, dy fjalë për Lëvizjen për Universitetin. Të thuash që Lëvizja është e infiltruar në protestën studentore, është si të thuash që Berisha është i infiltruar në Partinë Demokratike. Lëvizja për Universitetin (që ka në logo një grusht që mban një laps) iu sul që në ngjizje ligjit për arsimin e lartë, paralajmëroi studentët që nuk do i përballonin dot tarifat, gjuajti Ramën me vezë e Nikollën me salcë dhe, siç tregon foto, në 11 nëntor 2015 uli disa qindra studentë para Kryeministritë.

Sot (dje), pas incidentit me Jani Markën, pamë se si skena u mor nga një grupim me flamur e qeleshe që këndonin 'o sa mirë o hej', duke lënë të kuptohej se përvojën me turmat e kishin farkëtuar kryesisht në stadium. Momenti më i lumtur aty ishte kur turmën e mbajti me gjatë Robert Aliaj. Sloganet dhe refrenet tipike të protestës që ngjallen të gjithë publiku idenë se po përballen me dicka të re, janë krijuar nga Lëvizja për Universitetin.

Po, me aq sa kuptoj unë që ndoshta kuptoj gabim, Lëvizja ka



lidhje të fortë me Organizatën Politike, siç kishte Fronti Demokratik me PKS (kujdes, jo me PPSH, po flas për më herët në kohë). Ata janë një grup të rinjsh marksistë, ose marksistë-leninistë, ose sido që ta ketë emrin fraksioni ideologjik që përfaqëjnë, (se me këta prishesh për higjë, ta zëmë shkoni i thua gabimisht maoist një trockist). Kjo pjesë mua nuk më shqetëson. Edhe këta të tjerët që lebetiten nëpër rrjetet 'ata janë komunistë!', nuk besoj se kanë vërtet frikë se Arlind Qori do t'u marrë pronat. Unë kam simpati për veprimet e tyre, por nuk jam me ta. Nuk do kisha nerva për shembull të shkoja të Logu (një vend që kanë këta) e të dëgjoja ligjëratat me temë 'marxëdhënia mes fshatarësisë dhe proletariatit në Shqipërinë e viteve '30'. Pash zotin! A më pëlqejnë kur i shoh në veprim? Vdes fare. Po nuk jam me ata.

A ka mundësi të jenë vegla të Veliajt? Kjo është një pyetje që më ka munduar edhe mua. Në faqen e tyre FB shkruajnë se janë formësuar pas ngjarjeve të 21 janarit 2011. Në fakt, si më plak që jam, kujtoj që grupimi kishte si eksponentë kryesorë, nja dy vite më herët se 2011-ta, Leart Kolën, Andi Kananajn dhe Arbër Zaimin. Unë kam shkruar nja dy herë në gazetën "Gazeta", me të cilën besoj se merret Zaimi. Duke rremuar në internet, gjeta edhe një replikë që u kisha dërguar në 2009 në blogun e tyre saktivist, ku i pyesja si ka mundësi që shikoni shpresa të majta të partia socialiste (kishte nxjerrë Blushi ca teza të majta atëherë dhe këta i jepnin njëfarë përkrahje).

Me ardhjen e Rilindjes në push-tet, Learti dhe Kananaj u bënë drejtorë, kurse Zaimi iku në Prishtinë dhe u bashkua me Vetëvendosjen. Pra, një lidhje historike me personazhe të Mjafitit, OP e ka. Siç e tregon gjithë qejf edhe Altin Goxhaj me një video të një proteste gjatë vizitës së Avigdor Lieberman (ku isha edhe unë që, për parapritje, s'kam qenë kurrë pjesë e Mjafit). Por nga kjo, te teoria e konspira-

cioni se OP është levë sekrete e Veliajt, ka një distancë që e mbush imagjinata. Çfarë nuk bën vaki!

Por eksponentët e OP ishin ndër më aktivët te protestat kundër këndit të lojërave te Liqeni. Ishte në dobi apo në dëm të Veliajt ajo protestë? Mua më duket në dëm të tij, kështu iu duk edhe PD-së që andej nga fundi shkoi u bashkua dhe e dheu muhabetin.

Ceta, që është një skuadër grafitësh po ashtu u lidhur me OP, mbushi gjithë Tiranën me grafitin e Arditit që u vra në Sharrë, ndërkohë që çdo përpjekje për të folur publikisht për rastin u censurua. Në dëm apo në dobi të Veliajt ishte kjo?

Aktivistët e OP me Qorin në krye, u përlëshën me policinë, krah për krah me banorët te ish-Parku i Autobusëve për të mbrojtur një lulishje që u bë bllok pallatesh. Asnjë TV nuk e pasqyroi kurrë atë ngjarje, që të mos prishej me Veliajt.

Këto nuk janë kontestime koti të tipit 'hajm më bini pak që të duket sikur ju kam kundër'. Këto kanë goditur në zemër të pikave më të sulmuara të Velisë. Nëse Veliajt qenka kaq i sofistikuar, vallahi vërshtirë do jetë të mposhtet ndonjëherë.

Nëse OP, përkundrazi është një forcë e pakapur, kur do dalë ajo haptazi që të tentojë përballje me sistemin, ose konkurrimin elektoral brenda tij, si Vetëvendosje për shembull? Këtë nuk e di askush përveç atyre që janë në Organizatë, unë besoj se ata e diskutojnë këtë dhe ajo që di të them është se taktikat leniniste janë ndër më të suksesshme në histori.

3. Demokracia
Për ata që kanë pasur durim deri këtu, tani vjen pjesa me e rëndësishme për mua.

Kjo protestë e studentëve mbushi me shpresë të gjithë ata që duan të ndryshojnë ky sistem ku po vidhemi e s'po na pyet kush, herë nga njëra palë e herë nga tjetra. Protesta e studentëve është politike që ç'ke me të! 'Nuk jemi të varfër, jemi të vjedhur' shkruante

një parullë atje.

Shpërndarja e të ardhurave publike në këtë vend bëhet shumë keq dhe kjo është çështje politike. Kjo është çështja që bashkon protestën e studentëve me protestën e Astirit. Por për të pasur shpërndarje të drejtë, duhet pjesëmarrje në vendimmarrje. Kjo na takon të gjithëve.

Në vend t'u bëjmë thirrje studentëve të shkojnë te Kryeministria, ne duhet të dalim vetë, të gjithë bashkë a tek e tek, si të doni, por duhet të dalim të gjithë. Leksioni i protestës së studentëve ky është, dilni në rrugë! Po këtë duhet ta bëjmë vetë, jo të na e bëjnë studentët.

Problemi kryesor këtu është se demokracia iu vodh shqiptarëve, sidomos me ndryshimet në Kushtetutë në 2008.

A e dini ç'thotë Kushtetuta? Thotë që Kryeministri, nëse humb shumicën në parlament, e shpërndan parlamentin. D.m.th pakica e parlamentit vendos që parlamenti të shpërndahet. D.m.th nëse ata që ka vënë në lista kryetari i partisë i dalin kundër kryetarit, ky ua heq të drejtën e të qenit deputetë dhe nis hartimin e listave të reja. Kryetarët bëjnë lista dhe na i paraqesin në zgjedhje. Jeni apo s'jeni me këto lista? Për ata që janë të rinj, në kohë të 'Xhaxhi' kështu bëheshin zgjedhjet, jo Partia e Punës, por një organizatë që quhej Fronti Demokratik paraqiste një listë me kandidatë dhe t'i votoje pro ose kundër kësaj liste.

Kjo do të thotë që ne nuk zgjedhim përfaqësuesit tanë, për rrjedhojë ne nuk kemi përfaqësues në parlament, atje kanë përfaqësues kryetarët e partive.

Ne nuk kemi as të drejtë referendumi. Asnjë referendum nuk është bërë me iniciativë të qytetarëve. I vetmi që fitoi të drejtën ishte ai për ndalimin e importit të mbetjeve, edhe atë nuk e la të bëjë Rama se e hoqi importin e mbetjeve me VKM dhe pastaj ka vjet me vonë e ktheu serish për miratim në Parlament. A dini demokraci tjetër ku në 30 vjetët e fundit qytetarët nuk kanë bërë dot asnjë referendum?

Unë them që këtu lindin problemet tona. Ne nuk duhet ta shohim akoma veten vetëm si shqiptarë, ky është koncept i nja dy shekujve më herët. Ne duhet ta shohim veten si qytetarë të Republikës. Nëse nuk mendojmë politikisht, asgjë nuk kemi në vijë.

Hajde dalim në rrugë, ta shprehim zemërimin ndaj punës së keqe të kësaj qeverie, edhe ndaj tjetrit që do të vijë. Por edhe duke menduar një Kushtetutë të re që do na kthejë demokracinë. Kjo është më e vështirë se të vërshosh në rrugë, por është zgjidhja e vetme. Ne e kemi provuar herë pas here që të dëgjohejm, por kemi qenë pak. Nëse nuk jemi shumë, demokraci nuk mund të ketë.

Na thonë se drejtësia e reformuar do dënojë politikanët hajdutë, nuk ka drejtësi pa demokraci.

Ndërkohë shihemi në rrugë!

HOROSKOPI

DASHI

Yjet do ju favorizojnë sot në aspektin profesional. Parashikohet të keni një promovim që do ju kënaqte. Nga aspekti romantik, mund të keni një nxitje të brendshme për aventurë, e cila nuk do të zgjasë shumë.

DEMI

Një ditë e mbarë dhe plot fat parashikohet kjo e sotmja për të lindurit në shenjë tuaj. Gjithçka mund t'ju ecë mbarë sot si në aspektin profesional ashtu edhe në dashuri. Me parane nuk keni marrëdhënie të mirë.

BINJAKET

Mund të merrni lajme të mira në lidhje me paratë. Një investim të cilin e keni realizuar vite më parë mund t'ju sjellë fitime të kënaqshme. Në çështjet e dashurisë nuk jeni shumë i përbushur.

GAFORJA

Përpikuni të kaloni më shumë kohë me anëtarët e familjes. Duket se angazhimet e shumta kanë bërë që të lini pas dore njerëzit e afërt. Disa ngjarje të fundit mund ta forcojnë lidhjen tuaj.

LUANI

Pas një periudhë të vështirë në fushën e ndjenjave dhe dashurisë, duket se po kaloni momente te qeta. Nuk keni nevojë për një partner për të qenë i lumtur. Duke menduar pozitivisht gjërat do ju ecin mbarë.

VRIGJERESHA

Dëshira për ndryshim është e madhe në profesionin tuaj. Opsionet nuk janë të shumta. Përpikuni të gjeni një zgjidhje brenda vetes dhe më pas ta konkretizoni atë. Ndihma e dikujt do jetë e nevojshme.

PESHORJA

Parashikohen ndryshime pozitive në jetën sentimentale. Vendosija e planetëve ju sjell fat në dashuri. Nuk do të mungojnë eksperiencat e ndryshme, të cilat ju rrisin në karakter dhe ju formësojnë.

AKREPI

Keni një dëshirë të theksuar për varicionë në jetë. Aktualisht nuk favorizoheni për të ndërmarrë iniciativë të mëdha. Prisni një moment tjetër për të pasur ndryshime të domethënëse.

SHIGJETARI

Ditë e mbarë dhe me fat në fushën e parave. Duket se një shpërbim i majmë është në horizont. Më shumë sesa ana financiare, ju përbush suksesi në aspektin profesional. Në dashuri gjithçka ecën mirë.

BRICJAPI

Një dhuratë simbolike mund t'ju bëjë ditën shumë të këndshme. Çështjet e dashurisë po ju ecin mjaft mirë sot. Sa i përket anës profesionale, do të merrni disa lajme të mira. Shfrytëzoni aspektin e mirë që ju ofrohet.

UJORI

Nuk është dita më e mirë për sukses në dashuri. Kjo nuk do të thotë se ju duhet të hiqni dorë nga synimet tuaja. Brenda pak ditësh aspekti planetar do të jetë favorizues jo vetëm në dashuri.

PESHQIT

Situatë e favorshme në sektorin e parave. Nëse po planifikoni për të bërë një investim, fati nuk do ju mungojë ndaj këshilloheni për të vazhduar përpara me planet dhe projektet tuaja.

Opinion *i* Ditës

Plaku demode që nuk di të flasë më për veshët e studentëve

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... i Edi Ramës, thjesht kërkoni në "You Tube". Hyni aty dhe shikoni fjalimin e të njëjtit njeri, pesë vite më parë, atëherë kur studentët u ngritën të protestojnë kundër ardhjes së armëve kimike.

Atëherë, Rama sapo ishte futur në zyrë, i pangarkuar me peshën e vjedhjeve galopante, i pabërë pis prej lidhjeve me Saimirët, Gjushët, Ndokët, Frrokët e Prengët, i paprangosur me PPP dhe projektet miliardashe, ai ishte ende në gjendje t'u adresojë gjithë shqiptarëve.

Kthejuni edhe një herë atij fjalimi të vjeshtës 2013 dhe krahasojeni me monologun e sotëm.

Do të vini re një ndryshim kolasal.

Atëherë Rama ishte ende i lirë dhe mund të komunikonte me fjalorin e studentëve.

Ndërsa sot, po të qëmtosh monologun e tij, vëren se e vetmja shpresë që i ka mbetur është gjuha e urrejtjes ndaj Lulit, Monikës, analistëve që duan të vënë flakën për t'u krehur në mbremje nëpër banaqe, neokomunistëve dhe Qorit që nderon me grusht mbi varret e dëshmorëve, profesorëve që kujtojnë se u erdhi dita të bëjnë dhjetor të dytë, apo atij dekanit, të cilin një teori konspirative e përshkruan si njeriun që i vuri benzinën zjarrit.

Përpos kësaj gjuhe, kryeministri duket edhe më demode e jashtë kohe kur tentoi të krahasojë me



qeverinë "Berisha", me universitetet që ka mbyllur që nga koha e tij, me mënyrën si merreshin atëherë doktoratat dhe si rrëmbehej diploma e natës.

Lë të imagjinojmë për një çast se të gjitha këto janë të vërteta. Le të braktisin kundërshtarët e rilindjes? Kush e ka ndjekur qoftë edhe përciptas protestën para Ministrisë të Arsimit e ka dalluar lehtësisht se pjesëmarrësit e saj bërtasin në kor: "Jo politikë".

Po në fund të fundit, ç'u intere-

son studentëve kjo gjë studentëve?

C'lidhje kanë ata me të gjithë të lartpërmendurit?

Si mund të ftohen ata të futen në zyrën e tij (të të mirit pra) dhe të braktisin kundërshtarët e rilindjes?

Kush e ka ndjekur qoftë edhe përciptas protestën para Ministrisë të Arsimit e ka dalluar lehtësisht se pjesëmarrësit e saj bërtasin në kor: "Jo politikë".

Sepse ata kanë një kredo shumë më të madhe, që me sa duket Rama nuk e kupton.

Ata janë ngritur jo vetëm kundër Edi Ramës, por kundër gjithë këtij sistemi, që u merr paratë dhe u jep diploma të pavlera, i ndërthen në konvikte mizerabël, për të mos u siguruar vende pune, i shkollon në Shqipëri, për t'i përgatitur për pjatlarës në Gjermani.

Në thelb, ata janë kundër të

gjithëve dhe pak më shumë kundër kryeministrit të radhës, vetëm për faktin se ai sot gjendet në pushtet.

Prandaj, t'u flasësh atyre për diferencat dhe mospajtimet brenda një bote që e refuzojnë dhe e përbuzin si të tërë është një go-marllëk me brirë.

Pikërisht këtë bëri Rama sot.

Ai përdori instrumentet e një konflikti të vjetër për t'i folur brezit të ri. Ai u mundua të shpaloste konspiracione përçarëse, kontradikta të vjetruara, një gjuhë dhe një mendësi që ata, as e njohin dhe as e kuptojnë për t'i bindur të lënë protestën.

Ai u tregua i pazoti dhe i paaftë për t'i bindur edhe për qëllimin minimal që kishte: t'i bënte të braktisin rrugën dhe të dialogonin me të.

Në monologun e gjatë alla Fidel Kastro (mbi njëqind minuta), ku edhe ndonjë koncesion që lëshoi e fshehu nën kompleksin e vjetër se nuk po tërhiqej para opozitës, Rama i ngjau një lideri të plakur (jo fizikisht), jashtë mode dhe të paaftë të komunikojë me një gjeneratë të re.

Për ata studentët që protestojnë, ai është tashmë në pension dhe ka filluar atë jetën e tretë, të cilën e ka reklamuar aq shumë në mediat e kazanit.

Nëse doni të bindeni për këtë, thjesht krahasojeni me veten. Hapni "You Tube" dhe shikoni fjalimin e tërheqjes nga armët kimike.

Intervista *e* Ditës

Fevziu tek "A Show": Mallkimi i mandatit të dytë, pse nuk po qeveris dot Edi Rama

"Skandal pas skandali ka nisur historia e mandatit të dytë të qeverisë Rama". Kështu shprehet gazetari Bldi Fevziu, i cili mendon se kryeministri Edi Rama nuk po qeveris dot. Në një intervistë për emisionin "A Show" në "News24" Fevziu e sheh si një fenomen të zakonshëm jo vetëm për këtë qeveri por edhe të mëparshmet, një farë mallkimi që iu ndodh në mandatit e dytë.

Një ndër skandalet më të mëdha të qeverisë së Ramës është çështja e rrëmbimit të personave në Vlorë. Për Bldi Fevziu, rrëmbimi i personave në Vlorë, është një ndër ato ngjarjet që të kujtojnë Italinë e mafias së viteve 50, apo zonat më të këqija mafioze të globit. "Është një histori kriminale që duhet të marrë fund. Pas atij emisioni kur unë kam trajtuar këtë temë, kam kuptuar se në këtë ngjarje



kriminale janë të përshirë absolutisht oficerë të policisë së shtetit", tha Fevziu.

I pyetur për qeverisjen Rama në mandatit e dytë të saj, Fevziu beson se Rama nuk po qeveris dot pasi është mbërthyer nga skandalet e njëpasnjëshme.

"Kjo qeveri është shumë më keq në mandatit e dytë të saj. Nuk po qeveris dot. Skandal pas skandali. Rreth gjashtë muaj me çështjen e Tahirrit, gjashtë muaj me vëllain e Fatmir Xhafës, tani me çështjen e studentëve, m çështjen unazës, që tregon që skandal pas skandali nuk po e lejojnë që të ketë një qeverisje normale. Ka një mallkim të mandatit të dytë në Shqipëri që e kanë vuajtur të gjithë kryeministrat. Mandati i dytë është një lloj zvarritje për kryeministrin por për fat të keq është zvarritje për vendin", tha Fevziu.

Nuk kanë fund cudirat në futbollin shqiptar. Migen Memelli nuk do të jetë më trajner i Laçit pas humbjes minimale ndaj Flamurtarit. Tekniku pogradecar, që arriti të grumbullonte 10 pikë në 6 ndeshje, do të zëvendësohet nga Besnik Prenga. Emri i 49-vjeçarit nga Mirdita nuk është i panjohur për klubin kurbinas, pasi Prenga drejtoi skuadrën bardhezi në eliminatoret e Ligës së

E kërkoi presidenti Laska

Çudia e radhës te Laçi, shkarkohet Memelli, rikthehet Prenga

Europës, teksa eliminoi qipriotët e Anorthosis në turin e parë. Mësohet se trajneri i është përgjigjur pozitivisht ftesës së drejtuesve dhe ka pranuar të rikthehet në krye të skuadrës. Lajmi është konfirmuar edhe nga vetë trajneri, Besnik Prenga, i cili në një prononcim të shkurtër për "Panorama Sport" ka deklaruar: "Po është e vërtetë, presidenti i Laçit më ka kërkuar që ta ndihmoj dhe i jap përgjigjur pozitivisht".

SULMUESI KUQEZI

Në Zvicër të sigurt, Sadiku rikthehet te Lugano

Një lajm i bujshëm është duke qarkulluar në mediat zvicerane. Bëhet fjalë për sulmuesin Armando Sadiku. Sipas "Corriere del Ticino", bomberi nga Elbasani mund të rikthehet te skuadra e Luganos në muajin janar. Aktualisht Sadiku është pjesë e Levantes në La Liga, teksa vuajti një dëmtim, që e

mbajti atë për një kohë të gjatë larg fushave të lojës. 27-vjeçari është në fazën e fundit të rikuperimit, dhe rikthimi te Lugano do të ishte një opsion i mirë për të kapur formën e dikurshme, duke qenë se konkurrenca te Levante është shumë e egër, ndaj edhe do ishte vështirë që të fitonte minuta pas dëmtimit. Media zvicerane raporton se shqiptari mund të transferohet në formë huazimi te ish-skuadra e tij, për t'iu bashkuar sërish në qershor spanjollëve të Levantes.

Ylli i Juventusit në një rrëfim të rrallë për të kaluarën, pritshmëritë e tij dhe duelin e madh



Jeton Selimi

Ronaldo sfidon Mesin: Eja dhe fito në Itali!

Portugezi përgëzon Modriçin për "Topin e Artë"

Transferimi më i bujshëm në merkaton e verës, padyshim që ishte kalimi i Cristiano Ronaldos nga Real Madridi në kampionatin italian, ku firmosi me Juventusin. Në një rrëfim të gjatë për mediat, portugezi ka folur për disa çështje, mes së cilave për rivalitetin me Mesin, "Topin e Artë" për Modriçin, ndryshimet mes Italisë dhe Spanjës, apo edhe ambientin që ka gjetur te Juventusin.

AMBIENTI TE JUVENTUSI

"Ajo që më ka mahnitur, duke më ndihmuar në zgjedhjen, është organizimi i pabesueshëm që ka ky klub. Këtu të gjithë lojtarët dhe njerëzit që punojnë për klubin janë shumë punëtorë. E ulin kokën dhe punojnë fort. Ka qetësi: nëse për shembull Dibala ose Mandzukic nuk shënojnë sërish mund të jenë të buzëqeshur. Mund të them se jemi më shumë si një familje sesa te Real Madridi".

NDRYSHIMI ME SPANJËN

"Ndryshon shumë mentaliteti. Këtu skuadrat janë më të interesuara për mbrojtjen, ndërsa në Spanjë luajnë për të shënuar. Pastaj ka një ndryshim të madh në klube. Në Spanjë jeni gjithmonë në tension, ndërsa në Itali kam gjetur



një ambient ku ke më shumë mundësi për t'u relaksuar".

NDESHJET MË ME RËNDËSI

"Derbi është gjithnjë stimulus dhe te Juventusin nuk duan kurrsesi ta humbasin kundër Torinos. Mund të them se ndeshja ndaj Torinos, është shumë e ngjashme

me atë kundër Interit dhe asnjëra nuk duhet humbur. Një ditë, edhe magazinieri më kërkoi të fitonim në derbi, ose përndryshe do të kisha probleme me gjyshen e tij".

RIVALITETI ME MESIN

"Unë nuk e konsideroj një ri-

valitet midis meje dhe atij. Secili prej nesh bëri atë që duhej të bënte për klubet që luante. Unë kam pasur sukses kudo, madje edhe me ekipin kombëtar dhe nuk më ka mbetur më asgjë për të provuar. Besoj shumë të vetja. Ai zgjodhi të qëndronte përgjithmonë në Barcelonë. Nëse është i lumtur, e respektoj vendimin e tij, por shpresoj ta shoh atë një ditë në Itali sepse mund të them se më mungon".

TOPI I ARTË

"Unë punoj shumë dhe mendoj se e meritoj gjithmonë. Unë e respektoj vendimin, por numrat nuk gënjëjnë. Megjithatë, mos mendoni se pse humba "Topin e Artë" nuk më zë as gjumi. Kam një familje të mrekullueshme, shumë miq dhe luaj në një nga klubet më të mira në botë. Jam i zhgënjyer, natyrisht, por do të punoj shumë që të rikthehem si fitues i tij".

LUKA MODRIÇ

"Natyrishit që e përgëzoj. Por vitin e ardhshëm do të jetë një tjetër histori, pasi të dy do të kemi mundësi të shohim njëri-tjetrin dhe unë do të jem sërish aty".



Heshën për problemet në zemër

Vdekja e Astorit, klinika diagnostikue nën akuzë

Kur kanë kaluar më tepër se 9 muaj që nga data kur qendërmbrojtësi dhe njëherazi kapiteni i Fiorentinës, Davide Astori humbi jetën në hotel, gjatë një grumbullimi para ndeshjes me Udinesen, fakte tronditëse kanë dalë nga hetuesit e ngjarjes. Sipas mediave italiane, mbrojtësi italian kishte kryer elektro-kardiogramën në korrik të 2016-ës, për të marrë certifikatën e aftësisë sportive dhe në të ishte konstatuar një ekstrasistolë në dy morfologji, një tregues se "kutia elektrike" e zemrës nuk funksiononte, siç duhet. Pyetja që ka ngritur prokuroria italiane në këtë rast është nëse duhej certifikuar Astori për të luajtur futboll, apo duhej ndaluar. Ekspertët thonë se në rast të një konstatimi të tillë, urdhërohet kryerja e të tjera ekzaminimeve, për të zbuluar nëse kemi të bëjmë me sëmundje vdekjeprurëse të zemrës. Në fakt, Astori vuan nga një formë fillestare e kardiomiopatisë aritmogjene të barkushës së djathtë, e cila vret në mënyrë progresive qelizat miokardit, duke zëvendësuar ato me qelizat e yndyrës dhe fitor që mund të pengojnë funksionimin normal të zemrës dhe të shndërrohen në sëmundje vdekjeprurëse. Po sipas mediave italiane, prokuroria e Firences po heton për "vrasje dashje" dy mjekë italianë, që vijnë nga strukturat publike, të ngarkuara për certifikimin e futbollistëve, në lidhje me aftësinë e tyre për të ushtruar sport. Davide Astori u gjet i vdekur mëngjesin e 4 marsit të këtij viti në një hotel në Friuli, ku skuadra e tij Fiorentina kishte udhëtuar për të luajtur në atë mesditë sfidë me Udinesen vendase. Ndaj nga jeta e Astorit bëri që të shtyheshin ndeshjet e kampionatit italian, ndërsa të nesërmen në homazhe morën pjesë mijëra njerëz nga bota e sportit.

CHAMPIONS LEAGUE


Me vendin e parë në grup të sigurt dhe e kualifikuar për në fazën tjetër të Champions League, Barcelona e trajnerit Ernesto Valverde pritet të luajë me rezervat ndaj Totenhemit. Është ndeshja e fundit në grup dhe në fushë do të jenë lojtarët e stollit katalanas. Sipas asaj që raporton "SPORT", trajneri Valverde duhet t'u japë mundësinë e aktivizimit të gjithë lojtarëve që deri tani i ka përdorur pak ose aspak. Në portë duhet të jetë holandezi Clessen, ndërsa përpara tij do të luajnë Seme-

Kujdes Inter, Barça sot luan me rezervat ndaj Totenhemit

do, Vermaelen, Çumi dhe Miranda. Në mesfushë pritet të aktivizohen Denis Suarez, Çaris Alena dhe Arthur, ndërsa në sulm Munir, Koutinho dhe njëri mes Mesit dhe Suarez. Një Barcelonë ndryshe, që rrjedhimisht i komplikon shanset e Interit për kualifikim, sepse nëse nuk fitojnë katalanasit, nuk ka vlera as fitorja e zikaltërve ndaj PSV-së. Megjithatë, ka shpresa që edhe me këtë formacion Barcelona ta ndalë To-

CHAMPIONS LEAGUE	
NDESHJET E FUNDIT	
GRUPI A	
Bryzh - Atletiko Madrid	21:00
Monako - Borussia Dortmund	21:00
GRUPI B	
Barcelona - Totenhem	21:00
Inter - PSV Eindhoven	21:00
GRUPI C	
Crvena Zvezda - PSG	21:00
Liverpul - Napoli	21:00
GRUPI D	
Gallatasaraji - Porto	18:55
Shalke - Lokomotiv Moska	21:00

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- U shkrua nga Zweig.
- Fillojnë aksionin.
- Janë për tu krenrtuar.
- Sejdini i tarinerëve.
- Ai i Don Kishoit ishte Sanço Pança.
- Ekstreme në tunel.
- I ka tek vrapit.
- Fillojnë andej.
- Nuk tregohet nga i pasigurti.
- Luftojnë me pagesë.
- Inicialet e Gere aktor.
- Sirena që i dha emrin Napolit.
- Gjysmë feje.
- E ka simbolin Co një i tillë.
- Inicialet e Kazan, regjisor.
- Turner aktore.
- Në radhë të parë.
- As unë as ti.
- Janë galeri në rrugë.

- Gibson aktor.
- Ritet pa zë.
- Është edhe ajo e futbollit.
- Një studio... skulptori.
- Janë fushat pa fund në veri të Orinokos.
- Fund shkurti.
- Fillojnë ideologjinë.
- Është materia e trurit.
- Një është atleti
- Është ajo që i ka lënë pas të gjithë.

VERTIKAL

- Është edhe ajo epizooitike.
- Një është edhe Korabi.
- I këni në dorë.
- Është mbulesë mbi... hambar.
- Kufijtë e kuqesës.
- Janë tek në faqe.
- Kështu përfundon Loreley.
- Një vend nisjeje.
- Në këtë moment.
- Në krye të artistëve.
- Robbins aktor.
- Ai i Hekurt ishte Bismarck.
- Qërohen me... llogari.
- U shkrua nga Kundera.
- Është dhuna me fjalë.
- Yoko e John Lennon.
- Një vepër... taumaturgu.
- Ente Ekonomike Autonome.
- Një mund të jetë cirku.
- Janë indigjenë neozelandezë.
- Është edhe ajo gjeografike.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishin formacionet e famshme maqedonase.
- Është e zakonshme për pushime
- Emil piktor.
- Një planet i Kuq.
- Një garë në hipodrom.
- Me të nxjerrin një litër.
- Qorre pa qe.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Është trofe sportiv.
- U hahen... të martuarve.
- Kufizojnë një truk.
- Kërcimi i Zorba Grekut.
- Mund të jenë kohore.
- Kardashian, aktore dhe modele.
- Janë përmasa.
- Është pjesë e gjuhës.
- Nafta e Shell.
- Një i dhjetë në vit.
- Letra pa zë.
- Janë qederet, dëmet.
- Ishin kundërshtarë të babilonasve.
- Është llon papagalli.
- Tregon çmimin me... mirësjellje.
- Fillojnë ndeshjet.
- Të parat në stadium.

VERTIKAL


- Në krye të kryesisë.
- Është shfaqje e parë.
- Ross këngëtare.
- Kërkojnë talent të tilla.
- Të parat në stadium.
- Një pjesë e makinacioneve.
- Vrau Hektorin.
- Roth aktor
- Qe piktor i famshëm italian.
- Janë vjedhës.
- Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
- Një çiklist në velodrom.
- Është e ardhur nga firmat piramidale.
- Pak diktaturë.
- Një mund të jetë me... ku-ku.
- Nota e diapazonit.
- Masin lëngje të tilla.
- Janë forma.
- I vidhet ustait.
- Është pjesë telefilmii.
- Pikas pa ekstreme.
- Është ëmbëlsirë me qiri.
- Umberto poet italian.
- Dy asa.
- Kollet por jo kot.
- Radiotelevizioni i Kosovës.
- Inicialet e Delon.
- Fillojnë afërsisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1	9		7	8	4			
	7		9		5			2
		8						
3			6			7	9	
7		5				2		
				4	5	3		6
5	2			1		9	3	
		7	3					
8		1		2				

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	8	9	3	6	1	4	5	2
1	3	4	2	9	5	8	6	7
2	5	6	4	7	8	9	1	3
3	4	1	5	8	2	6	7	9
6	9	2	7	1	3	5	8	4
8	7	5	9	4	6	2	3	1
9	6	8	1	2	7	3	4	5
4	1	3	6	5	9	7	2	8
5	2	7	8	3	4	1	9	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

-Mos e kaloni gjysmën e jetës tuaj duke thënë se çfarë do të bëni dhe gjysmën tjetër të shpjegoni se pse nuk e keni bërë.

Mos e kaloni gjysmën e jetës tuaj duke thënë se çfarë do të bëni dhe gjysmën tjetër të shpjegoni se pse nuk e keni bërë.

"Duhet ta pranojmë që ndonjëherë jeta i sjell gjërë në këtë mënyrë. Mendimet e njerëzve, ndjenjat e tyre humbasin, shuhen, dhe të tjera vijnë, të reja.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	T	5	4	11		4		1	19	3	13	4	16
12	H	1	5	6	3	10	9	3		11	4	13	6
1	E	13		7	11		4		19	4	7		2
16	S		11	1	5	4	14	15	6	5	3	4	
		7	1	5	1	14	18	1	12	3	2	2	
15	1	7	1	13	7	3	19	3		1	13	16	
4	14	1		17	4	14		9	4	7	3	4	
9	6			5	3	11	3					9	19
4	5	5		3	1		4		12		3	5	
5	1	4	2		16	1	2	2	1	5	16		
1		18	1	5		4	9	4	14	1	7	3	
7	5	4	13	7	3		4		4	10	3	2	

B	A	S	T	E	T	P	A	P	A
U	R	A	T	U	R	H	P	A	
S	A	M	M	M	A	R	A	I	N
T	A	M	E	R	I	K	A	N	E
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R
B	E	T	O	N	E	K	B	O	A
S	A	L	I	R	A	M	A	E	
G	O	N	T	I	T	U	L	L	A
A	R	E	S	A	O	E	N	E	
Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E
I	A	M	E	R	E	N	G	U	E

- Në një moment në këtë rrugë kuptojmë se jemi rritur .
- Çfarë është kuptimi të shqetësohemi për atë që ne mund ose nuk mund të kishim bërë për të kontrolluar rrugën që mori jeta jonë?
- Sigurisht janë mjaft njerëz si ju dhe unë që të pakten u përpoqëm dhe ofruam diçka të vërtete, diçka të çmuar.
- Dhe nëse disa prej nesh janë të gatshëm të sakrifikojnë shumë gjëra në jetën e tyre për të ndjekur këto aspirata, me siguri kjo në vetvete, pavarësisht nga rezultati, do të sjellë krenari dhe kënaqësi "

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL

1. U shkrua nga Zweig. **M A M A M M E P K E L**

2. Fillojnë aksionin. **A M I S I M O N I A B O**

3. Janë për tu krenrtuar. **T O T R E T O R I K A**

4. Sejdini i tarinerëve. **E N O K D O M A T E L O**

5. Ai i Don Kishoit ishte Sanço Pança. **R M A R T I R E T T O**

6. Ekstreme në tunel. **I A R A T O N E E R R**

7. I ka tek vrapit. **A N M Q I L A R R O D**

8. Fillojnë andej. **L E N T E V I E A P L E R**

9. Nuk tregohet nga i pasigurti. **T E R R T I O R I A N D E M**

10. Luftojnë me pagesë. **K L A S A S P A R T A K U**

11. Është edhe ajo epizooitike. **K A K R I E R A R T**

12. Një është edhe Korabi. **M E R C E N A R O**

13. I këni në dorë. **G J I H U N I N J A**

14. Është mbulesë mbi... hambar. **J I T L G S U M O**

15. Kufijtë e kuqesës. **L E E E T O P A R**

16. Janë tek në faqe. **F I A T M S B R O T A**

17. Kështu përfundon Loreley. **R M R S A M O T E R O**

18. Një vend nisjeje. **O B E R O N M I A**

19. Në këtë moment. **N I N A M A T T H A U**

20. Në krye të artistëve. **T A S T I R O I D E T**

21. Robbins aktor. **I N T E R I M M K E N**

22. Ai i Hekurt ishte Bismarck.

23. Qërohen me... llogari.

24. U shkrua nga Kundera.

25. Është dhuna me fjalë.

26. Yoko e John Lennon.

27. Një vepër... taumaturgu.

28. Ente Ekonomike Autonome.

29. Një mund të jetë cirku.

30. Janë indigjenë neozelandezë.

31. Është edhe ajo gjeografike.

32. Inicialet e Klee piktor.

33. Ishin formacionet e famshme maqedonase.

34. Është e zakonshme për pushime

35. Emil piktor.

36. Një planet i Kuq.

37. Një garë në hipodrom.

38. Me të nxjerrin një litër.

39. Qorre pa qe.

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL

1. Është trofe sportiv.

2. U hahen... të martuarve.

3. Kufizojnë një truk.

4. Kërcimi i Zorba Grekut.

5. Mund të jenë kohore.

6. Kardashian, aktore dhe modele.

7. Janë përmasa.

8. Është pjesë e gjuhës.

9. Nafta e Shell.

10. Një i dhjetë në vit.

11. Letra pa zë.

12. Janë qederet, dëmet.

13. Ishin kundërshtarë të babilonasve.

14. Është llon papagalli.

15. Tregon çmimin me... mirësjellje.

16. Fillojnë ndeshjet.

17. Të parat në stadium.

VERTIKAL

1. Në krye të kryesisë.

2. Është shfaqje e parë.

3. Ross këngëtare.

4. Kërkojnë talent të tilla.

5. Të parat në stadium.

6. Një pjesë e makinacioneve.

7. Vrau Hektorin.

8. Roth aktor

9. Qe piktor i famshëm italian.

10. Janë vjedhës.

11. Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë

12. Një çiklist në velodrom.

13. Është e ardhur nga firmat piramidale.

14. Pak diktaturë.

15. Një mund të jetë me... ku-ku.

16. Nota e diapazonit.

17. Masin lëngje të tilla.

18. Janë forma.

19. I vidhet ustait.

20. Është pjesë telefilmii.

21. Pikas pa ekstreme.

22. Është ëmbëlsirë me qiri.

23. Umberto poet italian.

24. Dy asa.

25. Kollet por jo kot.

26. Radiotelevizioni i Kosovës.

27. Inicialet e Delon.

28. Fillojnë afërsisht.

